


**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E
RAPORTIT TE THELLUAR TE VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS
PER AKTIVITETIN MINERARE
SHFRYTEZIM ME KARIERE
SIPERFAQESORE I MINERALIT GELQEROR
PLLAKOR**

Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, sipas ligjit Nr.10440 date 7.7.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” aktiviteti perfshihet ne shtojcen I Kodi 19)



**Vëndndodhja e ushtrimit të Aktivitetit: Zona minerare Nr.347/6, Objekti“Krahës”
Njësia Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër.**

NËNTOR 2020

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT TË THELLUAR TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**EMËRTIMI I PROJEKTIT
SHFRYTËZIM ME KARIERRË I GELQERORËVE
PLLAKOR, OBJEKTI "KRAHËS", BASHKIA
MEMALIAJ, QARKU GJIROKASTËR.**

**POROSITËSI INVESTITORI
Subjekti "ALION" Sh.p.k.
ADMINISTRATORI**

Haxhi KRËKU

Haxhi KRËKU
"ALION" S.A.P.K
NIPT K328030140
BERAT-ALDANI
@ : 0692091459

RAPORTI VNM SË THELLUAR U HARTUA NGA:

"STUDIO PROJEKTI"

NIKOLLA SEFERAJ

Nikolla Seferaj



NËNTOR 2020

PERMBAJTJA E RAPORTIT TE THELLUAR TE VNM-së.

1	HYRJE.....	5
1.1	Informacion per qellimin e VNM dhe metodiken e zbatuar.	7
1.2	Qellimi i VNM- se.	8
1.3	Objektivat e VNM.....	8
1.4	Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.	9
1.5	Metodika e kryerjes se V.N.M- së.	9
1.6	Legjisllacioni.	10
2	Pershkrimi i projektit qe do te zbatohet per shfrytezimin e zones minerare Nr.347/6....	20
2.1	Qellimi i zhvillimit te aktivitetit.	20
2.2	Vendndodhja e objektit	20
2.3	Sigurimi teknik dhe numri i punonjesve qe do te punesohen dhe nga do te vijne. ..	24
2.4	Projekte te tjera qe do i vijne ne ndihme aktivitetit.	27
3	PERSHKRIMI TEKNIK	29
3.1	Tipi lendes se pare.	29
3.2	Pershkrim i sistemit të shfrytëzimit.	29
4	PERSHKRIMI I GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR DUKE PERFSHIRE.	50
4.1	Pershkrim te karakteristikave fizike te zones se projektit.	50
4.2	Pershkrim i biodiversitetit ne zonen e projektit.	52
4.3	Pershkrim i karakteristikave sociale te zones ku propozohet projekti.	57
5	PERSHKRIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PERFSHIHEN.	58
5.1	Ndikimet negative ne mjedis	58
5.2	Ndikimet e mundshme ne peizazh.	59
5.3	Ndikimet ne toke.....	59
5.4	Ndikimet ne uje.....	60
5.5	Ndikimet ne ajer.....	60
5.6	Ndikimi nga zhurmat.....	60
5.7	Ndikimet ne klime.....	60

5.8	Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike.	60
5.9	Ndikimet ne floren, faunen.	61
5.10	Ndikimet me natyre nderkufitare.	61
5.11	Ndikimi mbi popullsine.	61
5.12	Vleresimi i ndikimeve ne fazen e mbylljes.	61
6	NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT (NESE KA TE TILLA).	62
7	NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT.	62
8	MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV TE IDENTIFIKUAR.	62
9	PROGRAMIN I MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT.	64
9.1	Masat qe rekomandohen ne monitorim:	64
10	PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT.	65
10.1	Rolet dhe pergjegjesit per zbatimin e seciles mase te propozuara per mbrojtjen e mjedisit ne secilen faze te projektit.	65
11	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.	69
12	REKOMANDIME.	69

1 HYRJE

Subjekti "Alion" sh.p.k. ka marre pjese ne konkurimin e zhvilluar ne Ministrine e Energjise dhe industries per perfitimin e te drejtes per aplikimin ne (QKB) per Leje minerare shfrytezimi per zonen minerare konkruese Nr.347/6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise me daten 02/10/2020 me shkresen me Nr.6387/2 Prot eshte njoftuar nga MIE si fitues i ketij konkurimi dhe ka fituar te drejten e pergatitjes se dokumentave perkatese per pajisjen me leje minerare shfrytezimi ne zonen konkruese Nr.347/6.

Zona nr. 347/6 si dhe zonat e tjera konkruese, është publikuar për procedure konkurimi sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", pikës 5 dhe pikave 7/7 e 7/8 të VKM nr. 320, datë 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkruese", Urdhrit te Ministrit te Energjise dhe Industrise Nr 107, date 10.03.2014 "Per miratimin e planit vjetor per vitin 2014" i ndryshuar , e perfshire ne qarkun e Shkodres..

Prodhimi mineralit ndertimor gure gelqerore ne zonen minerare nr. 211/4 do te perdoret si lende shtese ne prodhimine çimentos per rritjen e markes se saje, etj .

Per shfrytezimin e ketij objekti, pjese e proçedures eshte edhe pajisja me lejet perkatese nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ne baze te **Ligjit Nr.10 440** date **07.07.2011** "**Per vleresimin e ndikimit ne mjedis**" *aktiviteti perfshihet ne Shtojcen 1 Kodi 19.*

Raporti Thelluar i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin minerar te shfrytezimit te vendburimit te gelqerorit pllakorr me (qiell te hapur) karriere u pergatit me kerkese te subjektit "**Alion**"**Sh.p.k.**, ne zbatim te legjislacionit Shqiptar.

Egzistenca e njerëzimit, veç të tjerave, është kushtëzuar me nevojën shfrytëzimit të burimeve natyrore të të gjitha llojeve. Shfrytëzimi i tyre nga njeriu në shekuj ka ardhur duke u rritur vazhdimisht, në lloj dhe sasi në raport me kërkesat njerzore.

Fillimisht, janë shfrytëzuar burimet natyrore për t'u ushqyer, strehuar e veshur dhe në vazhdimësi janë shfrytëzuar burimet natyrore të të gjitha llojeve duke përfshirë erën, energjinë diellore dhe mineralet për nevoja të tjera jetike.

Burimet natyrore dhe shkalla e shfrytëzimit të tyre ka qënë dhe mbetet një faktor përcaktues në shkallën e zhvillimit të shoqërisë.

Paralelisht shfrytëzimi i burimeve natyrore është shoqëruar dhe vazhdon të shoqërohet me ndikime në mjedisin ku ndodhen këto burime.

Këto ndikime shpesh janë rigjeneruar nga vetë natyra, brenda një kohe të caktuar, por në disa raste është dashur një kohë mjaft e gjatë për ta rikthyer mjedisin në gjendjen fillestare.

Rikthimi i mjedisit në gjëndjen fillestare ose në një mjedis të pranueshëm është bërë dhe mund të bëhet dhe me ndërhyrjen e aktivitetit njerzor.

E mira e kësaj është që ato të shkojnë paralel, duke mos ndikuar negativisht ndaj njëri tjetrit, por eksperiencia ka treguar që, në më të shumtën e rasteve, shfrytëzimi i burimeve natyrore ka lënë një ndikim të pa riparueshëm në mjedis, ose të kundërtën, për hir të mbrojtjes së mjedisit të caktuar nuk janë prekur burime natyrore të domosdoshme për jetën dhe zhvillimin e shoqërisë.

Teoria radikale "Çdo gjë për mjedisin" dhe ajo liberale "gjithçka për zhvillimin" janë kombinuar në teorinë moderne "*Zhvillim i qëndrueshëm dhe mjedis i pastër*".

Kjo devizë nënkupton doktrinën moderne e cila kapërnxen marrëveshjet klasike dhe lejon njëkohësisht aplikimin e një kontrolli dhe mbrojtje mjedisi, ashtu si edhe përmirësimin e teknologjisë industriale të orientuar drejt minimizimit të pasojave negative në mjedis.

Për pasojë mjedisi, relievi, bimësia, infrastruktura, atmosfera ndoten dhe dëmtohet sistematikisht, nga emetimi i gazrave dhe pluhurave duke na krijuar një tablo të zyrtë të peizazhit të karrierave dhe zonave rreth tyre.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve

mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore, ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si p.sh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, çdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor. Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- shterimi i burimeve
- ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoje se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter veçse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti lene keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithë. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat çojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytetet kryesore, ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

Shfrytezimi i lendes se pare ne disa vendburime kane çuar ne disa raste prishjen e disa ekuilibrave natyrore per shkak te nje shfrytezimi pa kriter, pa rregulla sipas nje ligjshmerie te caktuar shkencore.

Keto fenomene jane vene re ne shfrytezimin e lumenjve, vendburimeve afer qendrave te banuara, zonave turistike, zona me status te veçant mbrojtës etj.

Keqadministrimi i burimeve minerare, shfrytëzimit joracional i tyre, mos rehabilitimi i mjedisit dhe hapësirave të dëmtuara, mos marrja e masave për kontrollin dhe parandalimin e emetimeve të gazrave dhe pluhurave të ndryshëm, dëmtimi dhe ndotja e burimeve sipërfaqesore dhe nëntokësore të ujërave, sidomos në vendburime që ndodhet afër zonave urbane, përfshi dhe shkarkimet e pa kontrolluara, si dhe mungesa e masave të një trajtimi të duhur dhe ripërdorimit të mbetjeve, kanë çuar në një degradim të mjedisit dhe elementëve mjedisorë, pasqyruar në mënyrë të dukshme në dëmtimin e florës dhe faunës së zonës.

Theksojme se ne Shqipëri vendburime per prodhimin e lendeve te para si gur gelqeror, gelqeror pllakor, gabro traktolite, zhure, bazalte, argjila, gabro, gelqeror pllakor, kuarci etj. qe nuk prishin keto ekuilibra ndodhen ne gjithe territorin e vendit.

Studimi i thelluar i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin minerar prodhim minerali gelqerore pllakor me kariere u pergatit me kerkese te subjektit "ALION" sh.p.k. , ne zbatim te legjislacinit Shqiptar

Raporti synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor të projektit të propozuar në përdorimin e gelqerorit pllakor, efektet lidhur me ndikimet në floren, faunen, ujën, emetimin e gazeve të sere në atmosferë, shkarkimet në toke, ujë, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik në punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukurës dhe ndikimeve të tjera të rëndësishme mjedisore ose sociale, përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

- ✓ Analizën e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore, përcaktimin e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative.
- ✓ Shqyrtimin të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- ✓ Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit në fazën e përgatitjes së projektit.
- ✓ Të japë një gjendje sa më reale, nga pikepamja e ndikimit të aktivitetit
- ✓ Analizën e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore, përcaktimin e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative.
- ✓ Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.
- ✓ Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.

Hartimi i këtij studimi të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis parashikon dhe tenton së pari të përmirësojë vlerën ekologjike, gjatë shfrytëzimit të këtij objekti. Grupi i studimit ndërmori disa udhëtime në objekt ku pa nga afër dhe mbikqyri në vendin terrenin ku do të zhvillohet veprimtaria minerare e shfrytëzimit. Për këtë problem u bë mbikqyrja e terrenit në të gjithë zonën, duke kryer vëzhgime të ndryshme, si dhe të biodiversitetit.

1.1 Informacion për qëllimin e VNM dhe metodikën e zbatuar.

1.1.1 Përshkrim i qëllimit dhe objektivave të VNM.

Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis hartohet me kërkesë të shoqërisë “Alion” Sh.p.k. për aplikimin pranë QKL-së për procedurën e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në mjedis për zhvillimin e aktivitetit *Minerim Shfrytëzim me (qiell të hapur) karriere sipërfaqësore për shfrytëzimin e mineralit gelqeror pllakor*, me vendodhje në afërsi të fshatit **Krahës**, Njësia Administrative Krahës, Qarku Gjirokastrë.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis është një proces në vazhdimësi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore të rëndësishme, sinjifikante janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë në mënyrë të kënqshme në planifikim, projektim, zbatim të aktivitetit që do të zhvillohet në këtë objekt.

Studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis u orientua nga rëndësia dhe madhësia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre në identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes së projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative është nderthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive sidomos në kompesime indirekte mbi komunitetin.

VNM nuk do të mbulojë çdo aspekt të një efekti mjedisor të projektit, me të njëjtin nivel detajesh., Thëksi do të vihet në efektet kryesore që shkakton zhvillimi i aktivitetit. Gjithashtu një synim tjetër është që të përcaktojë e rekomandojë masat teknike- organizative për zbutjen e anëve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit dhe të japë informacion për vendim-marrësit për pasojat mjedisore të aktiviteteve të propozuara. VNM përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

- ✓ Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- ✓ Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- ✓ Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te shfrytezimit te kesaj karriere, mbi mjedisin human.
- ✓ Analizimin e faktoreve pozitive e negative mjedisore dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- ✓ Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne Mjedis te projektit.
- ✓ Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

1.2 Qellimi i VNM- se.

Subjekti me hartimin e ketij studim kerkon te informoje organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar.

Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit jo vetem nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari, por, krijon ndikim pozitiv ne disa drejtime si: zhvillim, punesim, rritje ekonomike dhe te ardhurave te pushtetit lokal e qendror, ne ndertimin e infrastruktures rrugore etj.

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit te shfrytezimit te mineralit te gelqeror pllakor.

VNM nuk do te mbuloj çdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh.

Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjetër eshte qe te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per

zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvellimit te aktivitetit dhe te jape informacion

per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet:

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit te shfrytezimit te mineralit gelqeror pllakor.
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

1.3 Objektivat e VNM.

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit minerar deri ne perfundim te aktivitetit, rehabilitimin e hapesires se shfrytezuar per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pasardhese.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose

veprimtari.

Objektivat e hartimit të VNM- se konsistojnë në evidentimin e ndikimeve në mjedis, në masat mbrojtëse të floras dhe faunas dhe masat tekniko-organizative për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit, gjatë kryerjes së aktivitetit minerar deri në përfundim të aktivitetit dhe rehabilitimin e hapësirës së shfrytëzuar dhe të prekur nga aktiviteti, për një mjedis të qëndrueshëm në vitet pas ardhese.

1.4 Objektivat e tjera të studimit të paraqitur janë.

- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale negative të projektit apo propozimit që do të kryhet;
- Përmirësimet mjedisore të zonës ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Përdorimin e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme ku respektohen dhe kërkesat e komunitetit të zonës për rreth.
- Mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe dëmtimet serioze të mjedisit;
- Lehtëson informimin e organeve vendim-marrësit, duke përfshirë vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore për zbatimin e projektit apo propozimit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peizazhet e natyrës dhe komponentet përberëse të ekosistemeve;
- Përmirëson aspektet sociale të projektit.
- Mbrojtjen e shëndetit të njeriut.
- Lehtëson informimin e organeve vendim-marrëse, duke përfshirë vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore për zbatimin e projektit apo propozimit.
- Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe dëmtimet serioze të mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peizazhet e natyrës dhe komponentet përberëse të ekosistemeve.

1.5 Metodika e kryerjes së V.N.M- së.

Studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis u orientua:

- Nga rëndësia e ndërtimit dhe shfrytëzimit të një karriere gelqerori pllakor me standarte bashkëkohore;
- Nga përmbushja e kërkesave vendase;
- Nga vendi ku kjo karriere do të ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre;
- Në identifikimin e ndikimeve negative lokale;
- Në marrjen e masave zbutëse duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike të investimit;
- Në masat orjentuese për një zhvillim të qëndrueshëm, etj.
- Në këtë raport identifikohen ndikimet lokale negative në mjediset humane si dhe është marrë parasysh vlerësimi i rrezikut.
- Reduktimi i ndikimeve negative është nderthurur dhe me ndikime të rëndësishme lokale dhe strukturore në këtë fazë kryesore:
- Hartimi i objektivave orientuese në raportin e V.N.M.;
- Mbledhja e materialeve baze egzistuese dhe plotësimi i formulareve përkatës për këtë raport (relacioni teknik, studimi gjeologjik-inxhinjistik, hidrologjik, etj) si dhe seleksionimi i tyre për përdorim. Verifikimi në terren i të dhënave egzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme biofizike dhe humane;

- Hartimi i V.N.M. dhe depozitimi tek porositesi “ALION” Sh.p.k. si dhe subjektet vendim-marrese dhe kontrolluese te aspekteve mjedisore ne nivel lokal e qendrore.

1.6 Legjislacioni.

- Ligj nr 12/2015 per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”
- VKM Nr.686 date 29.7.2015 “Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore”.
- VKM nr.419 date 25.6.2014 “Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollleshme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja”.
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
- Vendim nr. 13 date 4.1.2013 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis”.
- Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”.
- Ligji Nr. 10 448 date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”.
- Ligji Nr.10 440 date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.
- Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
- Udhezim Nr.1 date 03.03.2009 “Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis”.
- Udhezim Nr.3 date 19.11.2009 “Per metodologjine e raportit te VNM”.
- Urdhrin e ministrit Nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”.
- Udhezimin Nr. 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedisite te caktuara”.
- Udhezim Nr 3, datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”.
- VKM. Nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”.
- Ligji Nr .9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji Nr. 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”.
- Ligji Nr. 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji Nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.

- Ligj Nr. 8094 date 21.03.1996 “ Per largimin publik te mbeturinave”. Ligj Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM Nr. 533 datë 08.07.2005 “Për miratimin e rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”.
- Udhëzim Nr. 4, datë 15.4.2013, “Për dokumentacionin e aplikimit për leje mjedisi të tipit A, B dhe C në qendrën kombëtare të licencimit (QKL)”.
- Profili i zhvilluesit te aktivitetit.

- i. Emri i shoqerise sipas regjistrimit në QKR “**ALION**”**Sh.p.k;**
- ii. Numri i (NIPTI) **K32803014D**
- iii. Zona minerare me numur identifikues **Nr.347/6** objekti i gelqeroreve pllakor “**Krahës**”, Bashkia Memaliaj,QarkuGjirokastër, që është përfshire në planin vjetor **për vitin 2019**, nga Ministriae Infrastruktures dhe Energjise, per tu paisë me leje minerare shfrytezimi;
- iv. Lloji i mineralit për të cilin kërkohet dhënia e lejes gelqerori pllakor;
- v. Emri dhe mbiemri i administratorit të shoqeria aplikuese për leje minerare sipas regjistrimit të QKB, **Haxhi KRËKU**.
- vi. Adresa e selisë së shoqerise sipas regjistrimit në QKB,Berat, Lagjja “**Uznovë**”, rruga nacionale Gjirokastër - Poliçan, godina një katëshe, zona kadastrale Nr. 8504, me numër pasurie 179/35.
- vii. Nr. i telefonit /faksit **Cel: 0694294818, 0692091458**.
- viii. Email: **haxhikreku@hotmail.com**
- ix. Emri i njësisë vëndore ku përfshihet zona e kërkuar rrethi, **ish komuna Krahës (tani Njesia administrative Krahës) Bashkia Memaliaj, QarkuGjirokastër;**
- x. Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik **Besnik DINE;**
- xi. Data e përfundimit të liçencës profesionale të drejtuesit teknik; **Pa Afat;**

Zhvillimin i ketij aktiviteti dhe shfrytezimin i zones minerare Nr.347/6 shpallur ne planin vjetor te vitit 2019, objekti “Krahës”, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër.

Subjektit “**Alion**” **Sh.p.k.**, është një subjekt vendas e perbashket me ortak shqiptar. Objekti i ketij subjekti është:

Objekti i shoqerise sone ka qene dhe është: Nxjerja, përpunimi dhe shfrytëzimi i mineraleve të gurit gëlqeror pllakor dhe gurit ranorik në trajtë masive dhe në trajtë pllakor dhe tani se fundi do te aplikojë ne QKB per nje leje minerare shfrytezimi per gelqeror pllakor, pasi është pezulluar nxjerja e gurit gelqeror pllakor ne Malin e Tomorit.

Importi-Eksporti i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise si dhe te treteve i materialeve te mesiperme etj. Kerkim, zbulim, shfrytezim, eksport-import e perpunim te pjesshem te mineraleve, sipas percaktimit ne ligjin minerar, blerje, tregetim, magazinim dhe perdorim te lendes plasese, tregti me shumice e pakice, transport me shumicë

e pakicë të mineraleve, materiale të ndërtimi, vegla makineri e paisje, që perdoren në fushën e ndërtimit, shfrytëzimit të mineraleve, ndërtimin e hidrocentraleve me ujë dhe burime të rinovueshme dhe në çdo fushë tjetër që shoqëria e gjykon se është fitimprurëse, etj.

Kryerja e punimeve në fushën e gjeologjisë inxhinierike dhe hidrogeologjisë. Kryerja e punimeve gjeologjike dhe të zbulimit, punimeve minerare të hapjes, përgatitjes për shfrytëzimin e mineraleve dhe të materialeve të ndërtimit. Tregtim me shumicë e pakicë, import-eksport të artikujve të ndryshëm. Veprimtari në fushën e ndërtimit etj.

Tregeti me shumicë dhe pakicë të makinerive dhe paisjeve që nevojiten për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë. Tregeti me shumicë dhe pakicë të mineraleve të ndryshme metalor, jometalor, qymyret dhe bitumet, mineralet e ndërtimit, e të tjera, import eksport, transport për të tretë dhe kryerja e punimeve të ndryshme.

Marrja me nenkontraktim të punimeve të ndryshme për subjekte të tjera që shoqëria i gjykon fitimprurëse. Kryerja e ndërtimeve të ndryshme industriale dhe civile, godina me një dhe shumë kate, ndërtime të çfardo lloji karakteri dhe në çdo fushë duke përfshirë edhe ato të bujqësisë. Shoqëria jonë ka mjete financiare dhe teknike për të kryer investime dhe për të përballuar të gjitha detyrimet karshi shtetit apo palëve të treta për objektin që kërkon të kryejë shfrytëzimin e gelqerorit pllakor në koordinatat e zonës minerare Nr.347/6 objekti Krahës, Tepelenë, Qarku Gjirokastër, ku dhe në jemi shpallur fitues. Kjo shprehet në gjendjen bankare të shoqërisë të dhënë në dokumentat financiare ligjore dhe destinacionit të tyre për këtë aktivitet që sipas gjykimit të shoqërisë vlerësohet si fitimprurës.

Shoqëria pjesën më të madhe të makineri për nxjerrjen e mineraleve ndërtimor si makineri e pajisje shkriftuese, gërmuese, nxjerrëse, transportuese, i ka kryer dhe i ka gjendje për t'i vënë në dispozicion të shfrytëzimit të këtij objekti. Personeli i shoqërisë, kapacitetet e saj dhe mjete financiare dhe teknike, makinerite, janë garanci për suksesin në zhvillimin e kësaj veprimtarie minerare duke garantuar shtimin e vlerës së këtij minerali në Shqipëri dhe efektin social në hapjen e vendeve të reja të punës jo vetëm në veprimtarinë e shfrytëzimit, por dhe të përpunimit të mineralit në Qarkun Berat në Bashkitë Çorovodë dhe Berat dhe tani që po aplikojmë në Qarkun Gjirokastër Bashkia Memaliaj. Nga ana menaxheriale shoqëria ka staf dhe mjetet e nevojshme për prodhimin dhe transportin për në destinacionin e duhur të mineralit.

Shoqëria “**Alion**”**Sh.p.k.** ka eksperiencë të madhe në fushën e industrisë minerare. Kjo shoqëri ka eksperiencë në fushën e kryerjes së veprimtarisë minerare të shfrytëzimit pasi ka punuar me shumë subjekte në vendin tone dhe jashtë vendit kryesisht me Greqinë dhe me Italinë. Shoqëria ka filluar shfrytëzimin e materialeve ndërtimor qysh në vitin 2003 dhe ka rreth 17 vjet që kryen këtë veprimtari si për nxjerrje edhe për përpunimin e materialeve ndërtimor. Kjo shoqëri ka të gjitha kapacitetet teknike, profesionale dhe financiare për të kryer një shfrytëzim optimal dhe në përputhje me rregullat teknike që egzistojnë për këtë qëllim. Ajo ka një staf të kualifikuar punonjësish që merren me proceset e punës si nxjerrjen e pllakave, përpunimin, sistemit dhe transportin.

Kjo shoqëri është e njohur në kryerjen e veprimtarisë minerare të shfrytëzimit kryesisht për mineral minerale ndërtimor të ndryshme dhe përdorshme në fushën e ndërtimit.

Sa me sipër Subjekti “**Alion**” **Sh.p.k.**, ka shprehur interes për zgjerimin e aktivitetit të tij në shfrytëzimin e mineralit ndërtimor të gurit gelqeror pllakor në objektin “**Krahës**” Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër ku shpreson që me punimet e që do të kryejë të shfrytëzojë rezervën të konsiderueshme të mineralit ndërtimor të gurit gelqeror pllakor.

Në këtë objekt subjektit “**Alion**” **Sh.p.k.**, është shpallur fituese dhe ka aplikuar në QKB për leje kërkim-zbulimi.

Në këtë situatë, Subjekti “**Alion**” **Sh.p.k.** është mjaft i interesuar për zgjerim të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineraleve ndërtimor të ndryshme si të gurit gelqeror pllakor etj, për të vazhduar veprimtarinë e tij minerare të shfrytëzimit.

Kjo ka bere qe Subjekti “Alion” Sh.p.k. ka punuar ne mbledhjen e informacionit gjeologjik te rajonit nepermjet studimeve te saj dhe materialeve promovuese te MIE-së dhe shkembimit te informacionit me personelin inxhiniero teknik te tij dhe, do te kryeje punime minerare të shfrytëzimit ne disa zona si dhe, ne zonen minerare Nr. 347/6, shpallur ne planin vjetor 2020, dhe konkurimi u krye 05/08/2020 ku u shpall fitues subjekti yne.

Personeli inxhiniero teknik i kompanise prej me shume se nje vit qe ka punuar dhe po punon ne vleresimin e rezervave te mineralit ndertimor te gurit gelqeror ne rajonin e Bashkise Memaliaj, Qarku Gjirokastër. Ky vleresim eshte bere nepermjet aktivitetit te hapjes dhe shfrytëzimit te dy lejeve minerare te shfrytëzimit te miratuara nga Ministria e linjes ne kete rajaon. Subjekti yne ka nje periudhe te gjate qe kryen veprimtari minerare shfrytëzimit duke u pais me dy leje minerare te shfrytëzimit per minerale ndertimore ne qarkun e Beratit. Subjekti yne per keto dy leje minerare shfrytëzimi i ka finalizuar me miratimin e studimit teknik dhe projektit te shfrytëzimit ne Keshillin Teknik te Agjencise Kombetare te Burimeve Natyrore Tiranë. Studimet Teknike Ekonomik dhe Projektet e Shfrytëzimit jane hartuar për gëlqerorë pllakor dhe gur ranorik silicor qe bejne pjese ne grupin e mineraleve ndertimor. Ky shfrytëzim eshte kryer dhe do te kryhet edhe ne zonen Nr.347/6 që bën pjesë në objektin “Krahës” të ish Komunës Krahës me ndarjen e re administrative Njesia Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj, Tepelenë, Qarku Gjirokastër, është kryer me porosi të shoqërise private “Alion” Sh.p.k., e regjistruar në QKR Tiranë, me administrator zotin **Haxhi KRËKU** dhe me seli ne Uznovë, të rrethit Berat.

Nëpërmjet ketij studimi synohet të shfrytëzohen gëlqeror pllakor sipas ligjit Nr.10304, date 15/07/2010 “Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise”(te ndryshuar) dhe akteve nenligjore te dala në zberthim dhe per zbatim të tij, klasifikohen ne grupin e mineraleve ndertimorë. Shrytëzimi do të kryhet me qiell te hapur (karierë) pasi gelqerori pllakor ndodhet shume afer siperfaqes me nje mbulesë shume te vogel deluviale dhe te shkateruar te pa dobishem per pllaka per tregun vendas dhe te huaj.

Materiali i prodhuar nga ky aktivitet, do të përdoret kryesisht si lende e pare per prodhimin e pllakave dekorative natyrale dhe te perpunuara me permasa te ndryshme si dhe pllakave te perpunuara dhe te lustruara.

Sterilet dhe lende te tjera te padobishme si te shkateruar, mund te perdoren ne fusha te tjera te ndryshme si stabilizant ne shtrim rruges etj.

Gelqerori pllakor i ndodhur në këtë zone është studjuar mjaft mirë jo vetëm nga shoqeria jonë por dhe nga shumë subjekte që kane kryere dhe vazhdojne te kryejnë veprimtari minerare shfrytëzimi në këtë zonë. Materiali qe do te prodhohet në karrierë dhe ai i përpunuar në impiantin e kësaj shoqërie i kënaq kërkesat për t’u përdorur në Industrinë e ndërtimit.

Prodhimi vjetor minimal i planifikuar Cash Flow kur u krye konkurimi ne (MIE) me date 05/08/2020 për objektin e “Krahës”, Bashkia Memaliaj, Tepelenë, Qarku Gjirokastër është parashikuar të jetë **1,000 m³/vit ne vitin e pare**, prodhimi maksimal **12,000 m³/vit** nga viti i **XVII** deri ne vitin e **XXV** dhe prodhimi mezatar per **25 vjet**, do te jete, **7,720 m³/vit**, gur gëlqeror pllakor ne trajte pllake per tregun vendas dhe tregun e huaj, me mundësi rritje prodhimi, në perputhje me kerkesat e tregut. Kjo zone ben pjese ne Njësia Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër.

Per te filluar aktivitetin e shfrytëzimit ne objektin e mineralit ndertimor te gurit gelqeror pllakor, ne “Krahës”, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër, me pare u krye studimi i terrenit, percaktimin e llojit te punimeve te hapjes pergatitjes dhe shfrytëzimit qe do te kryhen si hapjaa e rugeve lidhese te objektit me rrugen Krahës-Kalivaç, nxjerrja e pllakave, shpimin e birave per pllaka t e gelqeroreve pllakor, perpunimi dhe sistemimi i tyre dhe sistemimi i mbeturinave ne sheshet provizore te depozitimit te sterileve, deri ne mbyllje te ketyre punimeve, rehabilitim te mjedisit te demtuar nga kryerja e punimeve te shfrytëzimit dhe rreth saj, subjekti porositi hartimin e dokumentacionit te nevojshem e te domosdoshem. Dokumentacioni u porosit dhe u hartua ne zbatim te kuadrit ligjor minerar, kryesisht te Ligjit

Nr. 10304, date 15.07.2010, (i ndryshuar) *"Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise"*, te amenduar dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.

Pjese e dokumentacionit eshte dhe Studim teknik ekonomik dhe projekti i zhvillimit te aktivitetit minerar te shfrytezimit te mineralit ndertimor te gurit gelqeror pllakor, zona minerare te Nr.347/6 objekti **“Krahës”**, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër.

*Projekti i shfrytezimit te mineralit ndertimor te gelqerorit pllakor “Krahës”
Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër ka per detyre te realizoje:*

Llojin i punimeve te shfrytezimit te objektit te gelqerorit pllakor.

- Rilevimi topografik ne Shkallen 1:1,000 siperfaqja 0.24 km².
- Rilevimi gjeologjik ne Shkallen 1:1,000 siperfaqja 13.959 km².
- Rruge e re per lidhjen e objektit dhe me rrugen Krahës-Kalivaç me gjatesi.
- Rruge te re per hapjen e shkalleve te karrieres me me gjatesi.
- Ndertimi i dy karrierave per shfrytezimin e gelqeroreve pllakor.
- Ndertimi i gjashte shkalleve te karrieres nga tre shkalle per sejcilen karriere.
- Ndertimi i dy shesheve te depozitimit te sterilit per sejcilen karriere nga nje.
- Çmontimi i te gjitha bazamenteve dhe makinerive e paisjeve te instaluar ne objektet.
- Rehabilitimi i karrieres per zonen e demtuar.
- Fuqine puntore.
- Vend ndodhjen e objektit, relievin, peisazhin etj.

Ne kete kuader qellimi i vetem dhe kryesor i projektit eshte percaktimi i menyres se kryerjes se punimeve per hapjen e shkalleve te karrieres, kryerjen e punimeve te shfrytezimi, treguesit teknologjik, kuadrit ligjor, dhe karakteristikave te tjera te objektit per me qellim te kryerjes se veprimtarise minerare te shfrytezimit te mineralit ndertimor te gurit gelqeror ne vendburimin **“Krahës”**.

Subjektit **“Alion” Sh.p.k.** zoteron mjetet e meposhtme:

Tabela 1 Lista e makinrive dhe paisjeve qe disponon subjektit “Alion” Sh.p.k.

Nr	Tipi i Mjetit	Vlera (Leke)
1	Kamion tip Benz, me targe AA563AX	1.500.000,0
2	Kamion tip SCANIA, me targe AA691GG Terheqes	1.024.173,0
3	Trajler rimorkio me targe ADR957	1.650.315,0
4	Kamion tip Benz, me targe AA 691 GB	300.000,0
5	Kamion tip Benz, me targe AA 154 VP (4 aks)	3.403.009,0
6	Komiocin tip Ford, me targ AA 659 RB	240.000,0
7	Matrapik i perdorur	100.409,0
8	Pirun ngrites i perdorur Komatsu FD-70-9	895.136,0
9	Makine sharuese e perdorur	1.143.825,0
10	Makineri per larje guri e perdorur	958.384,0
11	Prese hidraulike guri (Tranxh)	1.572.814,0
12	Eskavator CAT 320 BLN	2.524.404,0
13	Eskavator i perdorur ATLAS 11704	588.336,0
14	Makineri sharuese guri e perdorur	211.206,0
15	Ruli i perdorur Case vibramax	642.263,0
16	Pirun ngrites tip nisan	347.159,0
17	Lavatrice guri e perdorur 2 cope	1.065.807,0
18	Lavatrice e re Rundvibrator VRM 2000	3.348.197,0
19	Çekiç per eskavator	822.000,0
20	Eskavator CAT 325	600.000,0
	Totali	22.937.437,0



Figura 1 Foto ne afersi te zones ku do te kryhet aktiviteti minerar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINERAVE
DHË INDUSTRIJË

Nr. 6387/Prot.
1/2

Tiranë, më 02 / 10 /2020

Lënda: Njoftim Fituesi

SHOQËRISË "ALION" SH.P.K ✓
Lagjia "Uznovë", Rruga nacionale Berat – Poliçan, Berat

Nr.i Referencës: Zona Minerare Nr. 347/6, për objektin Krahës, Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, lloji mineralit gëlqeror pllakor, veprimtaria shfrytëzim, (fish leje minerare nr. 1107).

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron shoqërinë "Alion" sh.p.k. me NUIS K32803014D, me adresë: Lagjia "Uznovë", Rruga nacionale Berat – Poliçan, Berat, se oferta e paraqitur më datë 05.08.2020, për përfitimin e të drejtës për aplikimin për leje minerare në zonën minerare nr. 347/6, për vlerën totale të investimit prej 41 500 000 [dyzetë e një milion e pesqind mijë] lekë dhe sasinë e prodhimit të mineralit gëlqeror pllakor 7 000 [shtatë mijë] m³/vit, është pranuar si ofertë e suksesshme në procedurën e konkurrimit për të drejtën e aplikimit për leje minerare në zonën minerare konkurruese nr. 347/6, për objektin Krahës, Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, lloji mineralit gëlqeror pllakor, veprimtaria shfrytëzim, me kushtet që projekti i zhvillimit të veprimtarisë minerare që paraqitet me aplikimin në QKB duhet të përcaktojë:

- | | |
|--|---------------------------|
| • Prodhimi që mendohet të realizohet në zonën minerare | 7 000 m ³ /vit |
| • Sasia e prodhimit që do të përpunohet | 7 000 m ³ /vit |
| • Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer | 41 500 000 lekë |
| • Vlera e produkteve minerare | 3 338 128 000 lekë |
| • Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=...%) | 49 % |

Ofertuesi shoqëria "Alion" sh.p.k kërkohet t'i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. "Abdi Toptani" Nr. 1 – Tiranë:

- Kopjen e vënies në dijoni për Formularin e Njoftimit, të nënshkruar.
- Në rast se tërhiqeni nga aplikimi për lejen minerare duhet të njoftoni me shkrim jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendrike nga data e nënshkrimit të këtij njoftimi.

KRYETARI AUTORITETIT KONTRAKTUES

Belinda Baluku



FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË SUBJEKTIT FITUES

1. Autoriteti Kontraktues

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Adresa Rr. "Abdi Toptani", Nr. 1, Tiranë
Internet: www.infrastruktura.gov.al

2. Lloji i autoritetit kontraktues dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion Qendror	Institucion i Pavarur
X	<input type="checkbox"/>
Njësitë e Qeverisjes Vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

3. Objekti i Procedurës konkurruese

Për dhënie e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr. 347/6.

4. Vendndodhja e objektit të Procedurës konkurruese

Objekti: Krahës, Tepelenë, Qarku Gjirokastrë

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Bazuar në ofertën e paraqitur në procedurën konkurruese nga shoqëria "Alion" sh.p.k, rezulton se: Prodhimi që mendohet të realizohet në zonën minerare është 7 000 m³/vit; Sasia e prodhimit që do të përpunohet 7 000 m³/vit; Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer 41 500 000 lekë; Vlera e produkteve minerare që parashikohet të merren nga veprimtaria minerare në zonën minerare 3 338 128 000 lekë; Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=....%) parashikohet 49 %.

Numri i ofertave të dorëzuara: 1; Numri i ofertave të rregullta: 1

5. Referenca e dosjes, e përcaktuar sipas autoritetit kontraktues:

Nr. i Referencës së zonës minerare: Zona Minerare Konkurruese nr. 347/6, për objektin Krahës, Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, lloji mineralit gëlqeror pllakor, veprimtaria shfrytëzim, (ish leje minerare nr. 1107).

6. Emri dhe adresa e subjektit fitues

Emri "Alion" sh.p.k
Adresa Lagjia "Uznovë", Rruga nacionale Berat – Poliçan, Berat

E-mail

Adresa e Internetit

7. Vlerat e investimit, prodhimit përfundimtar të ofertës:

Vlera e investimit	<i>(pa TVSH) -monedha në lek</i>
41 500 000	<i>lekë</i>
Sasia e prodhimit	<i>(në ton/m³%)</i>
7 000	<i>m³/vit</i>

8. Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtën kontratë (nëse zbatohet):
Nuk zbatohet

Buletini i Njoftimeve Publike	Data	06.07.2020	Numri	41
----------------------------------	------	------------	-------	----

9. Informacione shtesë

Nuk ka

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 02.07.2020




Figura 2 Njoftim Fituesi.

2 Pershkrimi i projektit qe do te zbatohet per shfrytezimin e zones minerare Nr.347/6.

2.1 Qellimi i zhvillimit te aktivitetit.

Qellimi i projektit te propozuar eshte shfrytezimi i mineralit gelqeror pllakor me qiell te hapur (karriere) per furnizimin e tregut te industrise se ndertimit me pllaka me permasa te ndryshme qe e perdore kete mineral si lende te pare per prodhimin e pllakave te dimensineve te ndryshme, duke perdorur nje burim me kosto te ulet, ne gjendje qe te perkrah zhvillimin, ekonomik te shoqerise dhe te permiresoje gjendjen ekzistuese te lendeve te para si dhe Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin hapje, pergatitje dhe shfrytezim te mineralit, ne objektin “Krahës”, Njësia Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër.

2.2 Vendndodhja e objektit

Zona minerare Nr.347/6 ish leja minerare Nr.1107 objekti “Krahës”, Tepelenë, Qarku Gjirokastër, e percaktuar në planin vjetor të vitit 2020 dhe e publikuar për konkurim me date 05.08.2020 ora 10 00, per te cilen kerkohet te hartohet studimi tekniko ekonomik dhe projekti i shfrytezimit per tu pajise me leje minerare shfrytezimi. Kjo zone minerare perfshihet ne planshetat **K-34-124-D-a (Kuta) dhe K-34-124-D-c (Dhëmbllani)**, Tepelenë, Qarku Gjirokastër, me siperfaqe **0.240 km²**.

Objekti i kerkuar per te cilin hartohet studimi tekniko ekonomik ndodhet ne teritorin e ish komunes Krahës tani Njësia Administrative Krahës, Bashkim Memaliaj, Tepelenë, Qarku Gjirokastër. Ky objekt ndodhet ne krahun Perendimor te rruges automobilistike nacionale Levan-Tepelene rreth 2 km large kesaj rruge. Ky objekt ndodhet ne krahun e djathte te rruges rurale Krahës-Kalivaç qender qe lidh fshatin Krahës me fshatin Kalivaç. Objekti ndodhet ngjitur me rrugen rurale Krahës- Kalivaç. Kjo rruge eshte e asfaltuar dhe do te sherbeje per lidhjen e ketij objekti me kete rruge. Qendra administrative rurale e zones ne fjale eshte komuna Krahes. Ne pjesen veriore dhe ate jugore ky objekt kufizohet nga rruga automobilistike, kurse ne anen lindore e veri-lindore, jugore dhe veri-perendimore kufizohet nga zona te tjera shfrytezimi, ku disa subjekte te tjere ushtrojne aktivitet ne prodhimin e pllakave te gurit.. Rreth e rrotull objektit nuk ndodhen shtepi banimi, objekte social-kulturore, shkolla, depo etj. Zona per te cilen jemi licensuar pozicionohet ne kodren e Krahesit, Large qendrave te banuara, large rrugeve dhe eshte toke kodrinore pa ndonje zhvillim te bimesise. Objekti shtrihet ne kodrat e fshatit Krahes ne perendim qe bene pjese ne anen jug-lindore te kodrave te Krahesit me lartesi maksimale mbi nivelin e detit +383 m. Kuota e pjeses se poshtme te shaptit te malit ku kalon rruga Kalivaç-Krahës- eshte rreth 150 m.

Qendrat e banuar me te aferta nga objekti jane fshatrat Kalivaç, Zhulaj, Çorush, Krahës e cila ka qene qendra e Komunes me pare dhe me ndarjen e re administrative tani eshte Njesia Administrative e zones. Qendrat e banuar me te aferta nga objekti jane fshati Krahës i cili ndodhet 2 km large objektit ne lindje te tij. Ne perendim ndodhet fzhati Kalivaç i cili ndodhet 5 km large. asfaltuar dhe ne gjendje jo shume te mire.

Rruget ne rajon qe lidhin objektin me qendrat e banuara jane pergjithesisht te asfaltuar dhe nuk kerkojne riparime te medha.

Rruget ne rajon qe lidhin objektin me qendrat e banuara jane pergjithesisht te asfaltuar dhe kerkojne riparime te pjeseshme.

Ne lindje dhe jug-lindje zona pershkohet nga nje sere perrenjsh si perroi i fushes se Krahesit, perroi i Xhaxhait etj. Keta perrenje ujerat e tyre i derdhen ne lumin e Vjoses. Ne afersi te ketij objekti nuk ka qendra te tjera te banuara.

Objekti parshikohet te shfrytezohet perkatesisht me kuote te poshtme **+300 m** dhe kuote te siperme **+260 m, me nje disnivel prej 40 m** Ne lindje te objekti, pergjate rruges qe pershkon rajonin kalon nje linje elektrike 10 kv qe ka sherbyer per furnizim me energji elektrike te

fshatrave te zones perreth dhe do te sherbeje edhe per furnizimin me energji elektrike te objektit. Zona e kerkuar per shfrytezim ndodhet ne plashetin **K-34-125-D-a (Kuta)** ne shkalle 1:25,000 dhe kufizohet nga koordinatat e meposhtme:

Tabela nr. 2 Koordinatat e pikave qe kufizojne zonen e shfrytezimit.

Nr.	Y	X
1.	44 01 479	44 78 000
2.	44 01 950	44 78 000
3.	44 01 950	44 77 490
4.	44 01 479	44 77 490
Sip. = 0.240 km²		




Figura 3 Harta topografike me konturin e zones minerare konkurruese Nr.347/6 ish leja minerare Nr.1107, Objekti: “Krahës”, Tepelenë, Qarku Gjirokastrë.



Figura 4 Foto te pllakave te gelqerorit a ne objektin Krahës



Figura 5 Produkte qe do dalin nga pllakat e prodhuara ne objektin Krahës

2.3 Sigurimi teknik dhe numri i punonjesve qe do te punesohen dhe nga do te vijne.

2.3.1 Sigurimi teknik.

Në kryerjen e veprimtarisë minerare të shfrytëzimit do të merren të gjitha masat për sigurinë e punonjësve dhe të veprës, sikurse parashikohet në Rregulloren e Teknikës së Sigurimit për Minierat dhe Karrierat dhe Rregulloren e Teknikës së Sigurimit për Punët më Lende Plasëse në Miniera dhe në Naftë të Republikës së Shqipërisë, Rregullorja e Sigurimit Teknik për Përdorimin e Makinerive të Rënda, Shpuese, Gërmuese dhe Transportuese, kërkesat e Lejes së Shfrytëzimit, si dhe do të zbatohen gjitha kushtet mjedisore të parashikuara në Lejen Mjedisore qe do te lëshohet nga Ministria Turizmit dhe Mjedisit.

Gjate ushtrimit te aktivitetit minerar subjekti duhet te mbaje parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune do te jene me te rendesishmet dhe me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz.

Drejtuesi teknik i punimeve, para fillimit te punes dhe gjate saj, do te zbatoje rregullat dhe normat e percaktuara ne:

Regulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karrierat te Vitit 1999 te hartuar nga Instituti i Teknologjise Nxjerrese dhe Perpunuese te Mineraleve te miratuar me urdher te Ministrit Nr 132, date 07.04.1999 , mbeshtetur ne nenin 17 te Ligjit Minerar Shqipetar Nr 7796, date 17.02.1994, botuar ne vitin 2001

Rregulloren e Sigurimit Teknik per perdorimin e lendeve plasese dhe shperthyese. Rregulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit privat, do te zbatohen ne çdo proces pune te percaktuar ne plan-organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes , i cili duhet te permbaje :

Megjithatë gjykojmë si të nevojshme të përmendim disa nga rregullat:

- Punonjësit që do të punojnë në karrierë të pajisen më veshje punë, kapele minatori, çizme ose këpucë miniere, doreza, syze, kufje, të trajtohen me antidot dhe të jenë të siguar për kontributet nga sigurimet shoqërore dhe nga aksidentet në minierë;
- Gjate kryerjes së punimeve në karrierë të mos zbatohet asnjë urdhër që bie në kundërshtim me rregulloret e sigurimit teknik dhe që u rrezikon jetën punonjësve;
- Të ndalohet afrimi i mekanizmave pranë buzëve të shkallëve të karrierës më afër së 5 m.
- Të ndalohet qëndrimi i punëtorëve pranë shpateve të shkallëve të karrierës;
- Drejtimi teknik i punimeve gjatë hapjes, përgatitjes dhe shfrytëzimit, të kryhet nga inxhinieri i Minierës(drejtuesi teknik), i specializuar në këtë fushe;
- Drejtuesi Teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do të kryejë kontrollin teknik dhe azhurnimi e sasisë së punimeve minerare të çdo lloji për të cilat Shoqëria ka marrë leje shfrytëzimi;
- Drejtuesi teknik të kryejë instruktimin e punonjësve çdo tre muaj;
- Në kufijtë e zonës së minierës, për të paralajmëruar rrezikun gjatë kryerjes së punimeve në këtë karrierë, të vihen tabela paralajmëruese, të ngulura në toke;
- Vendosja tabelave të sigurisë (sipas standardeve të Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë.
- "Ndalohet hyrja e këmbësoreve " të vendosura në hyrjet;
- "Vini kokoren " dhe "mjetet mbrojtëse) në zonat ku kryhet veprimtari minerare shfrytëzimi;
- Në vijim parashikohen sa më poshtë;
- Përpilimi i "vlerësimit të shkruar të rrezikut profesional" në bazë të legjislacionit përkatës shqiptar dhe udhëzimeve të Autoriteteve Kompetentë shqiptare. Bëhet fjalë për një "sistem" regjistrimi dhe vlerësimi cilësor dhe sasior të rreziqeve të mundshme si dhe të përkeqësimit të shëndetit të punonjësve që punojnë në fazat e ndryshme të prodhimit dhe që përbehet - nga pikëpamja strukturore – nga;
- Hartimi i "dokumentit të sigurisë dhe shëndetit" në bazë të neneve dhe në baze të legjislacionit përkatës shqiptar dhe udhëzimeve të Autoriteteve Kompetentë shqiptare, roli i të cilit mbulohet deri në një masë nga hartimi i "vlerësimit të shkruar të rrezikut profesional";
- Në karrierë të vendosen tabela paralajmëruese për aktivitetin që kryhet ne ate zone;

Të respektohen elementet e shkallës, lartësia, gjërrësia e brezit të sigurimit, gjërrësia e sheshit të punës këndi i pjerrësisë së shkallës, këndi i shuarjes së shkallëve dhe të kryhet krehja e tyre nga copat e varura pas mbarimit të punës dhe para fillimit të punës për ngarkim;

- Përdoruesit e makinerive e pajisjeve të jenë persona të kualifikuar e të pajisur më dëshmi ushtrimi të profesionit;
- Pranë karrierës të vendoset një kuti e ndihmës së shpejt;
- Për kryerjen e punimeve në karrierë të hartohet nga drejtuesi teknik plan organizimi i punës para fillimit të punimeve dhe të miratohet nga administratori i shoqërisë;
- Rradha e kryerjes së punimeve do të përcaktohet hollësisht në planin e masave tekniko-organizative dhe do të miratohet nga administratori i Shoqërisë;
- Masat e teknikës së sigurimit do të zënë vendin kryesor në planin tekniko-organizativ;
- Punonjësit që do të përdorin lëndë plasëse në karrierë duhet të testohen çdo tremujor;
- Respektimi i përpiktë i rregullave të sigurisë gjatë transportimit, përdorimit të lëndëve plasëse dhe gjatë shpërthimeve (përkujdesje për largimin e makinerive dhe personelit, vendosje rojesh gjatë shpërthimeve, realizimin e shpërthimeve në fund të turnit);
- Të zbatohet një rrëgjim i rreptë për zbatimin e të gjitha pasaportave teknike;
- Në mbështetje të Studimit Teknik dhe Projektit të shfrytëzimit të hartohet projekti i zbatimit dhe për çdo ndryshim të merret leja në organet përkatëse;
- Siguria që ofrohet gjatë gjithë proceseve të punës në fazën e hapjes, shfrytëzimit dhe administrimit të vendburimit;

Kujdes i veçantë do të tregohet në krijimin e kushteve të punës, pastrimit të shesheve të shkalleve, rrugeve të transportit, krefjes dhe skarifikimit të shpateve të shkalleve të punës dhe nënshkalleve sidomos kur punohet në zonën me shkëmbinj me çarje;

Do të zbatohet një regjim i rreptë në aplikimin e pasaportave teknike të punimeve të ngarkimit dhe transportit të brendshëm;

Gjate ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti duhet të mbajë parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë për punonjësit janë me të rëndësishmet dhe me të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

Në hapjen dhe shfrytëzimin e karrierës do të punojnë një numër i nevojshëm punonjësish të cilët do të vijnë nga zona përreth, duke përfshirë të gjithë specialistet, punonjësit direkt në karriere, punonjësit e mirëmbajtjes, punonjësit e shërbimit dhe ato të administratës.

Gjate ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti duhet të mbajë parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë që janë me të rëndësishmet dhe me të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

Drejtuesi teknik i punimeve, para fillimit të punës dhe gjatë saj, do të zbatojë rregullat dhe normat e percaktuara në:

Regulloren e Teknikës së Sigurimit për Minierat dhe Karrierat të Vitit 1999 të hartuar nga Instituti i Teknologjisë Nxjerrëse dhe Perpunuese të Mineraleve të miratuar me urdher të Ministrit Nr 132, datë 07.04.1999, mbështetur në nenin 17 të Ligjit Minerar Shqipëtar Nr 7796, datë 17.02.1994, botuar në vitin 2001

Regulloret e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të punimeve dhe subjektit privat, do të zbatohen në çdo proces pune të percaktuar në plan- organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës, i cili duhet të përmbajë .:

- Plan organizimi i punimeve do të hartohet para fillimit të punimeve;
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve;
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do të bejë kontrollin teknik dhe azhurnimin e sakte të punimeve minerare të çdo lloji për të cilat subjekti ka marrë leje minerare shfrytëzimi;
- Rradha e kryerjes do të përcaktohet hollësisht në planin e masave tekniko-organizative dhe do të miratohet nga pronari i firmës;
- Në këtë plan tekniko-organizativ, masat e teknikës së sigurimit do të zënë vendin kryesor .
- Drejtuesi teknik i punimeve do të kryejë instruksione të rregullta mujore e tre mujore, ku do të trajtohen tema të veçanta për të gjitha profesionet
- Punonjësit, që do të punojnë në karriere për kontrollin e shpateve të shkalleve, shesheve të ngarkimit, rrugeve të transportit etj do të instruktohen rregullisht dhe do të ndjekin me rigorozitet zbatimin e rregullave dhe normave të Rr.T.S., që lidhen me këto probleme.

- Kujdes i veçantë do të tregohet në krijimin e kushteve të punës, pastrimit të shesheve të shkalleve, rrugeve të transportit, krefjes dhe skarifikimit të shpateve të shkalleve të punës dhe nënshkalleve sidomos kur punohet në zonën me shkëmbinj me çarje.
- Do të zbatohet një regjim i rreptë në aplikimin e pasaportave teknike të punimeve të ngarkimit dhe transportit të brendshëm.

2.3.2 Organizimi i punës.

Në kushtet gjeografike dhe klimaterike ku ndodhet karriera, shfrytëzimi i mineralit së bashku me punimet e tjera përgatitore (transhe, rruge dhe zbulim) parashikohet të zgjatë mbi **25 vjet**. Në të për kushte optimale pune për kapacitet **1,000 m³/vit** deri në **12,000 m³/vit** dhe kapaciteti mezzatar i pllakave të gelqerorit e prej **7,000 m³/vit** dhe zbulim nga **1,200m³/vit** deri në **11,000 m³/vit** parashikohet të punojnë:

Tabela nr. 3 Personeli i punës në Karriere.

Nr.	Personel	Persona
1	Drejtuës teknik inxh. minere	1
2	Puntoret e linjes së nxjerrjes	1
3	Minator dhe ndihmes	1
4	Eskavatorist, buldozjerist ndihmes	1
5	Shofere	1
6	Puntore të tjera	1
8	Roje objekti	2
9	Mirembajtës makinerish	1
10	Shuma	9

Regjimi i punës do të jetë me një deri dy nderese në ditë dhe 22-25 ditë në muaj, në stinën e dimrit prej muajit dhjetor deri në fund të muajit shkurt nuk do të punohet nuk do të kryhet veprimtari minerare shfrytëzimi për shkak të temperaturave të ulta.

Alternativat për zgjedhjen e vendit të ushtrimit të aktivitetit .

Mundësia e alternativave për organet vendim marrëse për të marrë në konsiderat për përzgjedhjen e vendodhjes së projektit nga subjektet minerare në teresi janë në nivelin zero për këto arsye:

- Zona minerare dhe objekti përcaktohet nga MIE me propozim të AKBN dhe shpallet në planin tre vjeçar dhe një vjeçar të Ministrisë.

- Investitorët që kryejnë aktivitete minerare janë para një fakti të kryer për pjesëmarrje në tender të zonave minerar të shpallura për konkurim.

Projekti hapjes së karrierës ka për qëllim lidhjen e fronteve të prodhimit të gelqerorit pllakor (të shesheve të shkalleve) me rrugën nacionale të transportit.

Hapja e vendburimit do të bëhet nga rruga ekzistuese që përshkon në pjesën jugore të karrierës. Hapja e vendburimit është projektuar në mënyrë që shfrytëzimi i gelqerorit pllakor me karriere të bëhet nga lart poshtë.

Teknologjia që do përdoret për shfrytëzimin e gelqerorit pllakor është e thjeshtë.

Rrezimi gurit gelqerorë në sheshet e shkalleve të shfrytëzimit do të bëhet me dhe pa përdorimin e lendeve plasuese të përdorimit civil të vendosura në bira marteli me thellësi 2-2.5 m për lartësi shkalle 10 m.

Ngarkimi i prodhimit në sheshin e shkalleve të shfrytëzimit do të kryhet me ekskavaor me zinxhira, me kapacitet kove 2 m³

Transporti i prodhimit deri në destinacion do të bëhet me atomjete vetshkarkuese 16 m³.

Gjeresisht mbi teknologjinë e përdorur për ndërtimin e punimeve dhe shfrytëzimin e gelqerorit pllakor në karriere do të gjeni në projektin teknik bashkangjitur.

2.4 Projekte te tjera qe do i vijne ne ndihme aktivitetit.

Ne kete aktivitet nuk do te kete objekte industriale prandaj nuk do te trajtojme struktura themelesh, konstruksione, e tjera se ato nuk ekzistojne.

Per tu mundesuar shfrytezimi i mineralit te te gelqeroreve pllakorne objektin Krahës do te behen punime ndertimore si hapja rruges nga rruga e ndertuar e cila eshte e lidhur me Kalivaç- Krahës deri në objekt në një gjatesi rreth 70 m. Hapja e ketij objekti eshte kryer me ndihmen e nje transheje kryesore te hapjes nga kuota +300 deri ne kuoten +260 m do te jete 777 m e gjate me pjerresi mezatore 8%. Rruge nga kuota e shkalles fundore e cila eshte kuota me e ulet deri kuoten me te ulte +260 . Ky segment rruge do te ndertohet brenda territorit te karrieres nga rruga ekzistuse automobilistike qe pershkon objektin ne tere gjatesine e tij.

2.4.1 Objekte te tjera ne sherbim te aktivitetit jane:

2.4.1.1 Sistemime për sheshet e ndërtimit të objekteve sipërfaqësore.

Eshte planifikuar shesh i vogel ndertimi per objektet siperfaqesore, ku do te vendosen nje kontinier i levizshem ne kuoten +300 m ne nivelin me te larte te karrieres, pothuajse ne qender te zones se shfrytezimit. Ky pozicion perkon me mezin e objektit qe do te shfrytezohet.

Zyra dhe ambiente te tjera.

Eshte planifikuar nje kontinier qe do te sherbeje per zyre dhe ambiente te tjera.

Dhome zhveshje

Nuk eshte planifikuar mbasi shoqeria i ka te ndertuar jo shume large objektit ne territorin e impjantit qe ka ne pronesi.

Fjetore.

Nuk do te kete ambjente per fjetore mbasi punonjesit qe do te punesohen do te jene nga zonat perreth.

Mensë.

Nuk eshte planifikuar mbasi do te trajtohen me ushqim te gatshem.

Magazine materialesh.

Eshte planifikuar nje ambjent brenda kontinierit qe do te sherbeje per magazinimin e materialeve te ndryshme qe nevojiten per nevoja emergjente.

Oficina dhe garazhi i automjeteve.

Nuk do te kete.

Depo e lendes-plasëse (ne sipërfaqe ose nëntoke).

Nuk eshte planifikuar te ndertohet depo e lendeve plasese mbasi plasja e lendeve eksplozive do te kryhet nga subjekte te specializuara qe do te kontraktoje shoqeria .

2.4.1.2 Furnizimin me uje.

Furnizimi me uje i objekteve te trajtimit dhe karrieres do te kryhet nga perroi i Krahës qe ndodhet ne krahun e majte te rruges Kalivaç-Krahës, poshte karrieres se kesaj Shoqerie, per kete qellim jane planifikuar investime.

2.4.1.3 Shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve.

Ne procese teknologjike te shfrytezimit te gelqerorit pllakor me kariere nuk do te perdoret uji. Aktiviteti prodhon mineral gelqeror pllakor pa pas nevojte te perdorimit te ujit teknologjik. Ne dite me rreshje ne kariere nuk punohet nje nder arsyt eshte se gelqerori pllakor me prezence uji pasi materiali qe shoqeron gure gelqerorein eshte argjile e cila perzihet me gelqerorin pllakor dhe e varferon ate. Uji do perdoret per lagjen e territorit per paksimin e pluhurave gjate procesit te nxjerrjes se gelqerorit dhe do sigurohet permes depozitave nga shoqeria.

Ujrat e ndotura nga pluhurat e krijuara ne kariere dhe ujerat e bardha qe do te kalojne ne kariere do te depozitohen ne vaskat qe do te ndertohen poshte sheshit te karrieres me kuote me te ulet +260. Praktikisht do te ndertohen dy vaska me keto parametra: gjatesi 6 m, gjeresi 3 m dhe thellesi 2 m. Uji i ndotur do te shkarkohet ne nje vaske dhe pasi te mbushet me llumra, ujerat kalojne ne vasken tjetere. Ujerat largohen nga vaska pasi te jene ngurtesuar dhe depozitohen ne sheshin e caktuar nga pushteti vendor ose ne sheshin e karrieres ne nje zone te percaktuar. Vaskat rrethohen me lartesi deri 2 m me rrjet metalike te qendrushme per tu mbrojtur nga renia e njerzve ne to dhe per menjanuar aksidentet ne pune. Ujerat e pastra pas vaskave do te riperdoren per eliminimin e

pluhurave ne karriere dhe ne procesin teknologjik. Ujrat e pastra pas vaskave do te riperdoren ose do te shkarkohen ne kolektrin kryesor te ujrave.

Gjithashtu mbetjet e krijuara ne karriere nga veprimtaria humane e punonjesve ose nga proceset e punes do te transportohen ne sheshin e depozitimit te miratuar nga pushteti vendor ose ne teritorin e karrieres dhe do te riciklohen ne mbyllje te aktivitetit per rehabilitimin e karrieres.




Figura 3 Skica e vaskave te depozitimit te llumrave qe mund te krijohen nga procesi i shfrytezimit.

Mbetjet sterile te krijuara nga procesi i zbulimit do te perdoren ne mbyllje te aktivitetit per rehabilitimin e karrieres dhe kthimin e mjedisit ne gjendjen e meparshme.

2.4.1.4 Rrugët automobilistike per hapjen dhe shfrytezimin e objektit.

Relievi i siperfaqes. ku ndodhet objekti, ka kushte te pershtateshme qe favorizojne hapjen me transhe me gjysem seksioni me nje kalim, gjerresia e saj do te jete ne funksion te menyres te transportit te gurit gelqeror dhe sterilit, paraprakisht eshte pranuar 6 m.

Per hapjen e objektit do te hapet nje rruga e re qe do ta lidhe ate me vendin ku do te ndertohet impianti i thyerjes , fraksionimit dhe perpunimit te pllakave Rruga eshte parashikuar te hapet me pjerresi 8-10%. Për hyrjen në objekt do të përdoren rrugët ekzistuese të cilat lidhin objektin me rrugën Krahës-Kalivaç. Për hyrjen në shkallet do të hapen rrugë të reja (rreth 200 deri 300 ml) të cilat me përfundimin e punimeve do të mbyllën dhe rehabilitohen. Hapja e rrugëve do të bëhet duke shkaktuar minimumin e dëmeve në mjedis.

Relievi i siperfaqes, ku ndodhet objekti, ka kushte te pershtateshme qe favorizojne hapjen me transhe me gjysem seksioni me nje kalim, gjerresia e saj do te jete ne funksion te menyres te transportit te gurit gelqeror pllakor dhe sterilit, paraprakisht eshte pranuar 6 m. Per hapjen e objektit do te ndertohet nje rruga e re qe do ta filloje me piken nr.1 ne ane te rruges Krahës-Kalivç. Rruga do te ndertohet ne nje terren ku nuk do te prek tokat e fshatit. Do te kaloje ne nje zone ku nuk do te kete shume pyll por shkurret te ulta dhe te pa dobishme. Rruga do te mbrije fillimisht ne kuoten +290 qe eshte kuota e nivelit te fundit te shfrytezimit si kuote me e larte dhe me tej do te ndertohet duke arritur ne kuoten +260 ku do te lidhi te gjitha shkallet e karrieres Nr.1 dhe Nr.2.

Rruga eshte parashikuar te hapet me pjerresi 8-10%. Nga kjo rruge, ne çdo 10 m lartesi kuote, do te hapen transhete e hyrjeve ne objekt per çdo shkalle dhe nenshkalte te cilat do te jene transhe prerese. Transhete do te pershkojone formacione te forta dhe te qendrueshme do te hapen duke perdorur punimet e shpim plasjes shoqeruar me lende plasjes e dhe shperthyese.

Zgjedhja e skarpates se transheve do te varet nga shtrirja e tyre ne raport me renien e gelqeroreve dhe do te jete nga 68° deri ne 70°.

Zgjedhja e skarpates se transheve do te varet nga shtrirja e tyre ne raport me renien e gelqeroreve dhe do te jete nga 68° deri ne 70°. Hapja e transhese kryesore per lidhjen e shkalleve te karriere, rruges lidhese qe do te lidh objektin me rrugen Krahës-Kalivaç do te kryhet me forcen mekanike te kovës se eskavatorit me perdorimin e çekiçit hidraulik per formacione jo shume te forta. Kur formacionet do te jete te forta do te shoqerohet edhe me perdorimin e ngarkesave te lehta me fitil detonant. Gjatesia e pergjithshme e transheve kryesore te hapjes do te jete 777 m.

3 PERSHKRIMI TEKNIK

3.1 Tipi lendes se pare.

Lenda e pare qe do te shfrytezohet eshte gelqeror pllakor. Ne ndertimin gjologjik te zones se shfrytezimit dhe me gjere marrin pjese shkembijnjte sedimentare qe fillojne me pllakat gelqerore te Kretakut te mesem dhe vazhdojne me depozitimet e Paleogenit dhe Neogenit dhe me te reja (Quat) te tipit te aluvioneve dhe deluvioneve.

3.2 Përshkrim i sistemit të shfrytëzimit.

Shfrytezimi i ketij vendburimi do te behet me qiell te hapur karriere. Ne zgjedhjen e menyres se shfrytezimit ka ndikuar me shume si faktore afersia pakove te cilat ndodhet shume afer siperfaqes. Ne zgjedhjen e menyres se shfrytezimit ushtrojne ndikimin e tyre faktoret e meposhtem:

- Menyra e transportit te mineralit te gelqeroreve pllakor.
- Menyra e transportit të zbulimit.
- Menyra e kryerjes se punimeve te prodhimit.
- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit.
- Konditat tekniko minerare te shfrytezimit.
- Kushtet e ndodhjes se ketij vendburimi.
- Relievi ku ndodhen vendburimi i gelqeroreve pllakor.
- Kendin e renies.
- Lidhja e vendburimit me rruge.
- Tipet e pranua te paisjeve ngarkuese dhe transportuese.

Zgjedhja e menyres se shfrytezimit me punime siperfaqesore ose nentokesore varet edhe nga shume faktore te tjere:

- Mundesi te medha per rritjen e prodhimit.
- Afatet e ndertimit te karrieres jane disa here me te shkrutra se sa ndertimi i minieres per te njejten prodhueshmeri.
- Nxjerrje me e madhe e sasise se rezervave qe arrin 90-97%.
- Konditat e ndodhjes se trupave ose objektit minerar afer siperfaqes ose jo.
- Kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike te objektit minerar.
- Konditat topografike (relievi).
- Lidhja e objektit minerar me rruget ekzistuese.
- Lidhja e objektit minerar me impiantet e perpunimit.
- Vellimi i mbuleses.
- Prodhimtaria vjetore.
- Vetite fiziko-mekanike.
- Tipet e paisjeve shpuese, germuese (ngarkuese) dhe transportuese.
- Afatet kohore te venies ne shfrytezim.

Nisur nga sa pershkruam me siper ky objekt minerar ka kushte shume te mira tekniko minerare per shfrytezimin me punime siperfaqesore. Shfrytezimi me punime siperfaqesore ne krahasim me shfrytezimin nentokesor ka shume avantazhe:

- Perdorimi i makinerive dhe paisjeve te fuqishme me tregues e rendiment te larte.
- Perdorimi i makinerive e paisje me permasa te medha.
- Siguria e larte ne pune.

- Rendiment me te larte te puntorit ne pune.
- Venia ne shfrytezim me shpejt me investime me te vogla per nje kohe me te shkurter.
- Kostoja e nxjerrjes se mineralit dhe levizja e mbuleses se ulet.

Duke patur parasysh sa me siper dhe kushtet e ketij vendburimi, mund te themi se menyra me e mire dhe me e mundshme e shfrytezimit per zbatim eshte ajo me qiell te hapur karriere. Shfrytezimi eshte parashikuar te kryhet nga larte-poshte duke filluar ne kuoten ku do te mberrije rruga automobilistike. Kjo kuote do te jete +300 e cila do te jete pika ku do te filloje shkalla +300 + 290 dhe do te vazhdojne ne shkallet +290+280,+280+270 dhe do te perfundoje ne shkallen +270+260. Shfrytezimi i ketij vendburimi eshte parashikuar te kryhet per 25 vite, meqense aq eshte dhe sasia e rezervave te mineralit te te gelqeroreve pllakor te planifikuar ne Cash-Fow e paraqitur ne kohen e konkurimit ku subjekti u shpall fitues. Shfrytezimi per kete periudhe 25 vjeçare eshte parashikuar te kryhet nga kuota +300 deri ne kuoten +260 i cili do te jete edhe niveli i fundit i shfrytezimit. Krahas kryerjes se shfrytezimit te pakove te gelqeroreve pllakor, do te kryhen punime gjeologjike per vazhdimin e zbulimit te metejshem te rezervave ne thellesi.

3.2.1 Përcaktimi i lartësisë së shkallës.

Ne percaktimin e lartesisë se shkalles jane patur parasysh keta faktore:

- Vetite fiziko-mekanike te shkembinjëve.
- Parrezikshmeria e kryerjes se punimeve.
- Kushtet tekniko-minerare te vendburimit.
- Kapaciteti prodhues vjetor i kerkuar.
- Tipi i paisjeve ngarkuese te mundshme per pune.

Nga analiza qe i eshte bere secilit prej faktoreve te siperpermendur, mund te themi se lartesia e shkalles e zgjedhur si me optimale dhe teknisht e zbatueshme, eshte 10 m duke e ndare ne nen shkalle ne lartesi 5 m dhe kete nenshkalle ne dy nenshkalle me te vogla me lartesi 2.5 m.

3.2.2 Ndarja e karrierës në shkallë, numri dhe kuota e tyre respektive.

Karriera eshte ndar ne katër shkalle me lartesi; $H = 10$ m secila. Lartesia e shkallese eshte llogaritur $h=10$ m. Shkalla me lartesi 10 m mund te ndahet ne kater nenshkalle me lartesi 2.5 m ose me pese nenshkalle me lartesi 2 m. Lartesia e shkalles percaktohet ne funksion te formacioneve, mjetet e germimit dhe ngarkimit, kapacitetit prodhues, menyres se shkriftimit te materialit, rrezes se kapjes se ekskavatorit etj. Ne kemi planifikuar rastin kur do te perdoret shkriftimi me germim direkt me forces prerese me fill te diamantuar dhe me ndihmen e birave prerese te shpuar me çekiç shpues te vendosur ne kollona vertikale dhe horizontale.

Spostimi i pllakave te prere me bira marteli do te kryhet duke perdorur hidrozbakator, fitil detonant, barut i zi, pyka meatlike prizmatike dhe cilindrike dhe me lende kimike qe zgjeron volumin e saj gjate qendrimin ne bira e shpuara per 24 ore rresht. Pllakat e shkeputur nga masivi me ndihmen e fadromes dhe te ekskavatorit do te manovrohen ne sheshin e karrieres per t'u perpunur dhe per t'u formen e rregullt per tregetim kubike ose drejtekendesh.

Karriera eshte ndare ne shkalle çdo 10 m lartesi duke lene nje brez sigurimi.

Shkallet qe do te hapen per shfrytezimin e rezervave do te jene: Shkalla +300 +290; shkalla +290 + 280; shkalla +280 +270 dhe shkalla e fundit e shfrytezimit do te jete +270+260. Kuota +260, do te jete niveli i fundit i shfrytezimit.

3.2.3 Parametrat gjeometrike te karrieres.

Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera, ne gjendje perfundimtare, do te kete pamjen e nje amfiteatri me shuarje graduale. Karriera e pjeses do te zhvillohet nga kuota +1350.5 deri ne kuoten +1280 m. (Parametrat e me poshtem jane per zhvillimin e karrieres deri ne kuoten +1280 m).

Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera, ne gjendje perfundimtare, do te kete pamjen e nje amfiteatri me shuarje graduale. Karriera e projektuar per tu shfrytezuar do te zhvillohet nga kuota +300 deri ne kuoten +260 m. (Parametrat e me poshtem jane per zhvillimin e karrieres deri ne kuoten +260 m).

Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera, ne gjendje perfundimtare, do te kete pamjen e nje amfiteatri me shuarje graduale perkatesisht.

1. Thellesia maksimale vertikale e karrieres gjate shfrytezimit te saj, 40 m;

- | | |
|---|----------|
| 2. Numuri i shkalleve te punes qe do te zhvillohen gjate shfrytezimit | 4; |
| 3. Gjerresia e karrieres Nr.2 Jugu ne pjesen e poshtem kuota +260, Karriera Nr.2 Jugu do te jete: | 40-52 m; |
| 4. Gjerresia e karrieres ne pjesen e poshtem kuota +260, Karriera Nr.1 Veri do te jete, | 12-90 m; |
| 5. Gjerresia totale ne pjesen e poshtem kuota +260, do te jete, | 26-71 m; |
| 6. Gjatesia e karrieres ne pjesen e poshtme kuota +260, karriera 2 do te jete, | 135 m; |
| 7. Gjatesia e karrieres ne pjesen e poshtme kuota +260, Karriera 1 do te jete, | 228 m; |
| 8. Gjatesia e totale ne pjesen e poshtme kuota +260, do te jete, | 363 m; |
| 9. Gjerresia e karrieres ne pjesen e sipërme kuota +290 do te jete, | 30-60 m; |
| 10. Gjatesia e karrieres ne pjesen e sipërme kuota +290 Karriera 2 do te jete, | 242 m; |
| 11. Gjatesia e karrieres ne pjesen e sipërme kuota +290 Karriera 1 do te jete, | 182 m; |
| 12. Gjatesia e totale ne pjesen e sipërme kuota +290 do te jete, | 424 m; |
| 13. Gjerresia maksimale e karrieres Nr.1 do te jete, | 120 m; |
| 14. Gjerresia maksimale e karrieres Nr.2 do te jete, | 75 m; |
| 15. Gjatesia maksimale e karrieres djathtas do te jete, | 230 m; |
| 16. Gjatesia maksimale e karrieres majtas do te jete, | 305 m; |
| 17. Gjatesia maksimale e karrieres totale majtas +djathtas do te jete, | 535 m; |
| 18. Kendi i shuarjes se shkalleve ne varesi te shtrirjes se karrieres do te jete, | 60-70°; |
| 19. Lartesia e shkalles, | 10 m; |
| 20. Lartesia e nenshkalles, | 2-2.5 m; |
| 21. Orientimi i transheve te hyrjeve do te jete nga lindja ne drejtim te veri-perendimit karriera nr.2 dhe nga perendimi ne drejtim te ver-lindjes karriera nr.1; | |
| 22. Orientimi i fronteve te shfrytezimit do te jete nga veriu ne drejtim te jugut, karriera nr.2, dhe nga jugu ne drejtim te veriut karriera nr.1; | |
| 23. Orientimi i te shfrytezimit do te jete nga lindja ne drejtim te veri-perendimit karriera nr.2 dhe nga perendimi ne drejtim te ver-lindjes karriera nr.1; | |
| 24. Siperfaqja e karrieres Nr.1, veri ne plan e projektuar per shfrytezim 24,000 m ² ose 2.4 ha. | |
| 25. Siperfaqja e karrieres Nr.2 jug ne plan e projektuar per shfrytezim 17,000 m ² ose 1.7 ha. | |
| 26. Siperfaqja e totale e karrieres nr.1+2 ne plan e projektuar per shfrytezim 41,000 m ² ose 4.1 ha; | |
| 27. Siperfaqja e zones minerare Nr.347/6 e shpallur eshte 240,000 m ² ose 24.0 ha; | |

3.2.4 Përshkrimi proceseve të seleksionimit, thyerjes, fraksionimit, pasurimit apo metoda të tjera që do të përdoren për përpunimin mineralit të te gelqeroreve pllakordhe realizimin e produkteve të parashikuara.

Minerali i ketij objekti do te shitet mbasi ti nenshtrohet procesit te perpunimit duke idhen forme te rregullt me makinerite e shoqerise “Alion“ Sh.p.k, te cilat do te vevdosen ne frontet e shfrytezimit. Shoqeria i ka mundesite me investimet e kryera qe ta tregtoje te rregullt pllaken er mineralit te gelqeroreve pllakor.

3.2.4.1 Përshkrimi i procesit teknologjike.

Proçesi teknologjik eshte pershkruar ne menyre te hollesishme Studimi Tekniko Ekonomik dhe Projekti i Shfrytëzimit i objektit gëlqerorit pllakor “Krahës”, është hartuar i mbështetur në Njoftimin e Fituesit derguar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise prane shoqerise sone me shkresen me Nr.6387/2 Prot. Date 02.10.2020. Numri i references se zones minerare : Zona Minerare konkruuese Nr.347/6, per objektin Krahës, QarkuGjirokastër, lloji i mineralit gelqeror pllakor, veprimtaria, shfrytezim, e miratuar ne planin vjetor te vitit 2020.

Proçeset kryesore teknologjike per shfrytezimin e objektit te mineralit ndertimor te gurit gelqeror pllakor, “Krahës”, me qellim shfrytezimin e rezervave te mineralit ndertimor te gurit gelqeror pllakor, do te jene:

1. Proçesi i pastrimit te siperfaqes nga bimesia.
2. Kryerja e punimeve te lidhjes se objektit me rrugen Krahës-Kalivaç.
3. Proçesi i pastrimit te siperfaqes nga bimesia.
4. Kryerja e punimeve te shkalleve te karrjeres. apja e kanaleve.
5. Pastimi i pakos produktive nga mbulesa vegjetale dhe sterile.

6. Nxjerrja e pllakave të gelqerorit pllakor.
7. Çmontimi i makinerive dhe paisjeve nga territori i zones që do të rehabilitohet.
8. Rehabilitimi i zones së demtuar nga kryerja e veprimtarisë minerare të shfrytëzimit.

Subjekti “Alion”Sh.p.k. me paisjen me leje minerare shfrytëzimi menjehere do të bëjë kërkesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të bërë propozim Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes së miratuar në lejen minerare të shfrytëzimit.

Me pas subjekti do të transportojë makineritë dhe paisjet të planifikuara për tu përdorur në objektin e gurit gelqeror pllakor Krahës. Menjehere do të fillohet nga ndërtimi i transhese kryesore të hapjes për lidhjen e objektit me rrugën Krahës-Kalivaç e gjatë 70 m. Kur do të takohen formacione të forta në seksionin e transhese dhe në vende të tjera do të përdoren punimet e shpimit –plasjes shoqëruar me lende plaese dhe shpërthyes.

Një pjesë e punimeve të hapjes së punimeve si transhe kryesore të hapjes dhe të prerjes, nxjerrja e pllakave të gelqerorit do të kryhet me përdorimin e punimeve të shpimit plasjes me përdorimin e lendeve plasese. Subjekti fitues dhe nenkontraktori do të përsërisht me **Autorizim për përdorimin civil të lëndëve plasëse nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, konformë ligjeve në fuqi.**

Me ndërtimin e transhese kryesore të hapjes do të fillojë të ndërtohet transheja e prerjes e horizontit +290 e cila do të shërbejë për hapjen e shkallës +300+290. Krahës avancimit të transhese së për horizontin +290 do të kryhet avacimi i trashese kryesore të hapjes për kryerjen e hapjes së horizonteve +280;+270;+ 260.

Sapo të krijohet pllakë e pare midis profilit VI-VI dhe profilit V-V mbi kuotën +290 do të fillojë pastrimi i sipërfaqes nga shkuret dhe masa e mbuleses mbi pakon produktive. Pastrimi i sipërfaqes nga shkuret dhe masës së mbuleses do të kryhet me ndihmën e koves së ekskavatorit dhe thikës së buldozierit. Shkuret do të ndahen veç dhe masa sterile do të depozitohet në sheshin e depozitimit. Pastrimi i mbuleses mbi pakon produktive do të kryhet deri në atë masë sa të dalin pllakat e gelqerorit të pa eroduar. Kur të jete hapur edhe pllakë midis profilit V-V dhe profilit IV-IV dhe të kryhet pastrimi i këtyre pllakave siç u krye në pllakën e pare. Në pllakën e pare të pastruar do të fillojë nxjerrja e pllakave të gelqerorit duke përdorur dy metoda.

- Metoda e pare konsistone në nxjerrjen e pllakave me dhembet e koves së ekskavatorit ose të fadromes.
- Metoda e dytë konsistone në kryerjen e shpimitit të birave në largësi 5-15 cm dhe duke konturuar në të gjitha anët dhe spostimi me pyka, lëndë kimike ose fitil detonant.

Metoda e pare konsiston duke futur dhembin e koves duke levizur disa pllaka njëhershë. Punonjësit me ndihmën e pykave i fusin ato në hapsirën e lire dhe vazhdimisht kryhet levizja e tyre duke nxjerrë pllakën në permasa që ndodhen në natyrë ose që mund të shkeputen.

Metoda e dytë konsiston në kryerjen e shpimitit të birave në largësi 5-15 cm dhe duke konturuar në të gjitha anët dhe spostimi me pyka, lëndë kimike ose fitil detonant. Pllakë konturohet me permatat që do të jenë edhe pllakat në natyrë. Me spostimin e pllakës nga masivi do të fillojë të kryhet nxjerrja e pllakave me leva dhe çekiç duke i sistemuar.

Mbeturinat që do të dalin gjatë prodhimit të pllakave do të ngarkohen me fadrome dhe ekskavator për tu transportuar në drejtim të sheshit të depozitimit të sterileve. Keto sterile në sheshin e depozitimit të sterileve do të qëndrojnë aq kohë sa të krijohet hapsirë e lire për rehabilitimin e shkalleve.

Në stinën e thatë kur do të krijohen pluhura në frontet e prodhimit, në rruget e karrierës do të kryhet sperkatja me ujë e tyre për të eliminuar ngritjen e tyre në ajër.

Kjo do të jete rradaa e kryerjes së proceseve teknologjike deri në vitin e 25 që është viti i fundit i afatit, të lejes minerare të shfrytëzimit.

Në përfundim hiqen të gjitha makineritë e paisjet prishen betonët në raste se ka kryhet rehabilitimi i zones së pa rehabilituar. Pas rehabilitimit subjekti do të kujdeset për një periudhë 2-3 vjet deri sa bimët e mbjella të marrin zhvillim.

Punonjësit që do të punojnë në këto procese teknologjike do të jenë punonjës të kualifikuar dhe të specializuar në këto procese teknologjike. Punonjësit që do të përsërisht do të përsërisht me mjete mbrojtëse, do të trajtohen me antidote. Punonjësit do të jenë të siguruar duke paguar kontribute të sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i jetës.

Me qenëse disponohen të dhëna të mjaftueshme lidhur me sistemin e çarjeve të shkëmbenjve në këtë objekt, duke gjykuar nga sistemi i çarjeve në sipërfaqe, i cili pritet që në këtë lloj shkëmbi të jete me

pak i zhvilluar ne thellesi, ne projekt parashikohet shkeputja e shkembenjve monolite ne forme pllakash me menytrat e me poshteme :

1. Ne fazen fillestare te prerjes se jo te rregullt, zona e fillimit te shkalles pas heqjes se shtreses se shkembenjve me çarje, e cila konsiderohet si faze kalimtare, parshikohet te kryhet shkeputja e tyre:
 - Ne rastin e prezences se çarjeve te dukshme me eskavator duke perdorur koven ose çekiçin hidraulik te vendosur ne krahun e eskavatorit;
 - Shkeputja e pllakave me ane te perdorimit te birave konturuese dhe pykave hidraulike;
2. Ne fazen e kaperximit te zones kalimtare dhe futjes ne zonen e shkembenjve monolite parashikohet te kryhet shkeputja e pllakave me trashesi te madhe ;
 - Me perdorimin e birave konturuese te pllaket dhe ndarjes me paisje hidraulike;
3. Shkeputja e pllakave te holla do te kryehet:
 - Me perdorimin e forces mekanike te dhembeve te koves se ekskavatorit.
 - Me perdorimin e forces mekanike te punonjesit dhe levave;

Theksojme se ne fazen fillestare te zbatimit te projektit do te ishte e rekomandueshme te perdorej shkeputja e pllakave monolite me ane te birave konturuese te pllaket dhe perdorimit te ndaresave hidraulike ose me koven e eskavatorit, çekiçit hidraulik te vendosur ne krahun e eskavatorit ose me perdorimin e fitilit detonant.

Gjithesesi menyra me e mire, nga ana teknike dhe ekonomike, e shkeputjes se pllakave do te ishte ajo e pererjes se dy faqeve me bira konturuese dhe me pyka hidraulike, hidrozbankator, ose duke perdorur forcn mekanike te koves dhe çekiçit hidraulik te vendosur ne krahun e ekskavatorit. Gjate shfrytezimit te objektit parshikohet te perdoren lende plasese te prodhimeve te fundit, si fitil detonat lende kimike qe zgjeron vellim e saj per hapjen dhe çarjen e pllakave si dhe perdorim i pjeseshem i lendeve plasese jo tradicionaleve por prodhime te koheve te fundit te shoqeruar me FITIL NONEL. Ato do te perdoren per shkriftimin e gelqerorit jashte zones me pllakave. Jashte zones me pllaka te gelqerorit per hapjen e rruges lidhese dhe per shkatrimin e gelqerorit gjate hapjes se rruges do te perdoret lende plase e tipeve te fundit shoqeruar me fitil nonel. Matererialet plasese dhe shperthyese do te perdoren edhe per shkriftimin e shkembenjeve qe nuk do te kene mundesi te shkriftohen me koven e eskavatorit ose te çekiçit hidraulik te vendosur ne krahun e tij. Ndikimi i ketyre materialeve eshte i paperfillshem pasi ato do te perdoren ne sasira shume te vogla dhe vetem ne rastet kur nuk mund te kryhet shkeputja e pllakave me pyka dhe me eskavator si dhe shkaterrimi i shkembinjve te forte.



Foto Nr.7 Nxjerrja e pllakave te gelqerorit ne objekt



Foto Nr.8 Nxjerrja e pllakave te gelqerorit ne objekt

Gelqerori pllakor i ndodhur në këtë zone është studjuar mjaft mirë jo vetëm nga shoqëria jonë por dhe nga shumë subjekte që kanë kryere dhe vazhdojnë të kryejnë veprimtari minerare shfrytëzimi në këtë zonë. Materiali që do të prodhohet në karrierë dhe ai i përpunuar në impiantin e kësaj shoqërie i kënaq

kërkesat për t'u përdorur në Industrinë e ndërtimit.

Objekti do të shfrytëzohet për një periudhë se paku 25 vjeçare me të drejte shtyrje edhe për një periudhë 10 vjeçare tjetër.

Nga kryerja e veprimtarisë minerare e shfrytëzimit relievi i shpatit do të ndryshojë formën si rezultat i kryerjes së rehabilitimit të shkalleve të karrieres karriera do të marrë një pamje të gjelberuar. Shfrytëzimi do të kryhet me qiell të hapur (karrierë) pasi gelqerori pllakor ndodhet shumë afër sipërfaqes me një mbulësë shumë të vogël deluviale dhe të shkateruar të pa dobishëm për bllok për tregun vendas dhe të huaj.

Materiali i prodhuar nga ky aktivitet, do të përdoret kryesisht si lende e pare për prodhimin e pllakave dhe dekorative me permasa të ndryshme si dhe pllakave të perpunuara dhe të lustruarar.

Sterilet dhe lende të tjera të padobishme si të shkateruar, mund të përdoren në fusha të tjera të ndryshme si stabilizant në shtrim rrugësh etj. si dhe për rehabilitimin e sipërfaqes së demtuar nga kryerja e veprimtarisë minerare të shfrytëzimit.

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI "KRAHËS", BASHKIA MEMALIAJ, QARKU GJIROKASTËR.




Figura 9 Harta gjeologjike e vendburimit

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI "KRAHËS", BASHKIA MEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.








Figura 10 Planimetria e karrieres me shkallet e saj ne gjendjen perfundimtare.

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI "KRAHËS", BASHKIA MEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.



PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI "KRAHËS", BASHKIA MEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.







Figura 11 Profilët I-I deri VIII-VIII me shkallet e karrieres ne gjendjen perfundimtare.




Figura 13 Pasaporta e shpim-plasjes me bira te shkurtra dore.








Figura 14 Harta me zonen e rrezikshme nga punimet me lende plasese.

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI "KRAHËS", BASHKIA MEMALIAJ, QARKU GJIROKASTËR.



Figura 14 Planimetria e karrieres me shkallet e saj te rehabilituara pas shfrytezimit.



PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA MEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.







Figura 15 Profilet I-I deri VIII-VIII me shkallet e karrieres te rehabilituara pas shfrytëzimit.

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI "KRAHËS", BASHKIA
MMEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**




Figura 17 Skema e shfrytezimit te gureve dekorative.

3.2.5 Kapaciteti prodhues dhe jeta e karrieres.

Kapaciteti prodhues i minieres eshte percaktuar duke patur parasysh faktoret e meposhtem:

1. Kerkesat e tregut per kete lloj minerali.
2. Permasat e vendburimit dhe kondita tekniko minerare.
3. Infrastruktura e zones.
4. Mundesia e perpunimit te ketij lloj minerali.
5. Afersia e ndertimit te fabrikes se perpunimit.
6. Aftesia tekniko financiare e subjektit per te realizuar kete sasi prodhimi.

Prodhimi qe do te realizohet nga shfrytezimi i ketij objekti ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit per prodhime pllakash per veshje te jashteme e te brendeshme, kolona , pllaka, etj. Kapaciteti vjetor i objekti eshte percaktuar ne perputhje me nevojat e tregut te shitjes dhe parashikohet te jete 1,000 m³ /vit deri 12,000 m³ /vit pllaka gelqerori dhe zbulimi 1,200 m³ /vit deri 1,800 m³ /vit bllok neto per tregun vendas nga ku do te perpunohen (do te levizen ne masiv) 6,000 deri ne 9,000 m³/vit gelqeror pllakor ne masiv.

3.2.6 Makinerite qe do te perdoren.

Per shfrytezimin e ketij objekti do te investohet ne blerjen e ketyre makinerive e pajisjeve;

- Sonde shpimi
- Motokompresor
- Ekskavator
- Fadrome me zinxhire
- Buldozer
- Automjet transporti

Nisur nga fakti qe objekti ndodhet afer qytetit te Memaliajs sherbimet teknike te makinerive qe operojne ne objekt do te kryhen ne ofcinat e ketij qyteti.

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MMEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

Ne zbatim te njoftimit fituesit te ministrit te MIE-se aktiviteti minerar shfrytezim gëlqeror pllakor do te kryhet ne objektin Krahës, Njesia administrative Krahës, Qarku Gjirokastrë.

-Siperfaqja e miratuar per shfrytezim totale eshte	0.240 km².
-Siperfaqja totale qe do ti nenshtrohet procesit te rehabilitimit duke perfshire karrieren, rruget jashte karriere dhe sheshin e depozitimit te sterileve do te jete:	0.057 km².
• Prodhimi qe mendohet te realizohet ne zonen minerare	7,000 m³/vit
• Sasia e prodhimi qe do te perpunohet	7,000 m³/vit
• Vlera e investimit qe parashikohet per tu kryer	41,500,000 leke.
• Vlera e produktit minerar	3,338,128,000 leke.
• Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=...%)	49%

3.2.7 Pershkrimi i procesit teknologjike.

Proçesi teknologjik i prodhimit te mineralit te te gelqeroreve pllakorne karriere eshte i thjesht. Shfrytezimi do te filloje ne kuten +300 dhe do te vazhdoje ne drejtim te kuotes +290,280,+270dhe +260 qe eshte kuota me e ulet e shfrytezimit. Shfrytezimi do te kryhet nga larte poshte

Me qenese disponohen te dhena te mjaftueshme lidhur me sistemin e çarjeve te shkembnjve monolite, duke gjykuar nga sistemi i çarjeve ne siperfaqe, i cili pritet qe ne kete lloj shkembni te jete me pak i zhvilluar ne thellesi, ne projekt parashikohet shkeputja e shkembnjve monolite ne forme pllakash me menytrat e me poshteme :

4. Ne fazen fillestare te prerjes se pllakave jo te rregullt, zona e fillimit te shkalles pas heqjes se shtreses se shkembnjve me çarje, e cila konsiderohet si faze kalimtare, parshikohet te behet shkeputja e tyre:
 - Ne rastin e prezences se çarjeve te dukshme me eskavator duke perdorur koven ose çekiçin e tij;
 - Shkeputja e pllakave me ane te perdorimit te birave konturuese dhe pykave hidraulike;
5. Ne fazen e kapercimit te zones kalimtare dhe futjes ne zonen e shkembnjve monolite parashikohet te behet shkeputja e pllakave :
 - Me perdorimin e birave konturuese te pllaket dhe ndares hidraulike ;
 - Me perdorimin e telit te diamantuar per prerjen e nje deri dy faqeve te pllaket, konturimi me bira dhe perdorimi i pykave hidraulike;
 - Me perdorimin e telit te diamantuar per prerjen e te gjitha faqeve te pllaket;

Theksojme se ne fazen fillestare te zbatimit te projektit do te ishte e rekomandueshme te perdorej shkeputja e pllakave monolite me ane te birave konturuese te pllaket dhe perdorimit te ndaresave hidraulike ose kova e eskavatorit dhe çekiçi i tij.

Eksperienca e perdorimit te telit te diamantuar ne karrieren analoge ne Shqiperi ka treguar se kjo metode nuk eshte shume e pershtateshme per masive me çarje dhe prani te damarve kuarcore nga te cilat shkaktohen difekte te njembasnjeshme te bllokimit dhe keputjes se telit .

Perveç sa me siper investimi fillestar i aplikimit te kesaj metode eshte i konsiderueshem. Aplikimi i saj mund te behet pas marrjes se te dhenave suplementare lidhur me sjelljen e shkembnjve ne prerje dhe dokumentimit te pranise se sistemeve te çarjeve dhe damareve kuarcore. Keto te dhena, ne shkalle te majftueshme, mund te sigurohen vetem pas kryerjes se disa punimeve minimale te shfrytezimit ne fazen fillesatre te karrieres .

Gjithsesi menyra me e mire, nga ana teknike dhe ekonomike, e shkeputjes se pllakave do te ishte ajo e pererjes se dy faqeve me tel te diamatuar dhe e nje faqeje me bira konturuese dhe pyka hidraulike Ngarkimi gëlqerorit pllakorne sheshin e shkalleve do te behet me eskavator me zinxhira me madhesi kove 2 m³ , eskavatori vendoset ne sheshin e shkalles se shfrytezimit. Transporti per ne destinacionin e kerkuar do te behet me automjete te posacme te cilat do te jene te mbuluara per te mos lejuar emetim pluhurash.

3.2.8 Sigurimi teknik.

Gjate ushtrimit te aktivitetit minerar subjekti duhet te mbaje parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune qe jane me te rendesishmet dhe me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz.

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MMEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

Drejtuesi teknik i punimeve, para fillimit të punës dhe gjatë saj, do të zbatojë rregullat dhe normat e përcaktuara në:

Regulloren e Teknikës së Sigurimit për Minierat dhe Karrierat të Vitit 1999 të hartuar nga Instituti i Teknologjisë Nxjerrëse dhe Perpunuese të Mineraleve të miratuar me urdher të Ministrit Nr 132, datë 07.04.1999, mbështetur në nenin 17 të Ligjit Minerar Shqipëtar Nr 7796, datë 17.02.1994, botuar në vitin 2001

Regulloret e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të punimeve dhe subjektit privat, do të zbatohen në çdo proces pune të përcaktuar në plan-organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës, i cili duhet të përmbajë:

- Plan organizimi i punimeve do të hartohet para fillimit të punimeve;
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve;
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do të bëjë kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të punimeve minerare të çdo lloji për të cilat subjekti ka marrë leje minerare shfrytëzimi;
- Rradha e kryerjes do të përcaktohet hollesisht në planin e masave tekniko-organizative dhe do të miratohet nga pronari i firmës;
- Në këtë plan tekniko-organizativ, masat e teknikës së sigurimit do të zënë vendin kryesor .
- Drejtuesi teknik i punimeve do të kryejë instruksione të rregullta mujore e tre mujore, ku do të trajtohen tema të veçanta për të gjitha profesionet
- Punonjësit, që do të punojnë në karriere për kontrollin e shpatëve të shkallëve, shesheve të ngarkimit, rrugeve të transportit etj do të instruktohen rregullisht dhe do të ndjekin me rigorozitet zbatimin e rregullave dhe normave të Rr.T.S., që lidhen me këto probleme.
- Punonjësit, që do të punojnë në karriere për kontrollin e shpatëve të shkallëve, shesheve të ngarkimit, rrugeve të transportit etj., do të instruktohen rregullisht dhe do të ndjekin me rigorozitet zbatimin e rregullave.
- Kujdes i veçantë do të tregohet në krijimin e kushteve të punës, pastrimit të shesheve të shkallëve, rrugeve të transportit, krefjes dhe skarifimit të shpatëve të shkallëve të punës dhe nënshkallëve sidomos kur punohet në zonën me shkëmbinj me çarje.
- Do të zbatohet një regjim i rreptë në aplikimin e pasaportave teknike të punimeve të ngarkimit dhe transportit të brendshëm.
- Një proces i veçantë që është karakteristik në këto raste është përmbysja e pllakave të prera. Gjatë kryerjes së këtij procesi do të kushtohet kujdesi i duhur dhe do të zbatohen të gjitha rregullat e Teknikës së sigurimit për këto procese.

3.2.9 Informacion për infrastrukturen e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujerave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rruget ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugeve të reja.

Subjekti në marrëveshje me OSHEE në zbatim të legjislationit Shqiptar do të furnizohet me energji elektrike nga linja e zonës duke nderhyrë me një lidhje të re, do të ndërtojë kabine transformimi dhe panel shpërndarje të energjisë për të furnizuar objektet e shërbimit dhe ndriçimin. Në këto kushte mund të themi se infrastruktura për lidhjen me rrjetin elektrik është e ngritur, ekzistuese por vetëm rrjetin elektrik për objektin. Në teknologjinë e shfrytëzimit të mineralit të gelqerorit pllakor me qiell të hapur (karriere) miniere sipërfaqesore nuk përdoren sasi të mëdha uji pasi ai mund të riciklohet.

Uji do të përdoret për kryerjen e shpimit të lagur në procesin teknologjik. Në periudhën e stinës të thatë për lagjen e rrugeve të levizjes së mjeteve të transportit dhe territorit të karrierës dhe për shërbime veti nga personeli shërbimit në miniere. Sasia e ujit do të jetë minimale rreth 20 m³ në ditë. Uji do të sigurohet me depozita nga shoqëria. Zona nuk është e pasur me burime ujore por do të merret në Memaliaj dhe burimet në afërsi të objektit.

Ujrat e ndotura nga pluhurat e krijuara do të depozitohen në vaskat e ndërtuara në sheshin e zonës që është marrë për shfrytëzim. Praktikisht do të ndërtohen dy vaska me këto parametra: gjatësi 6 m, gjerësi 3 m dhe thellesi 2 m. Uji i ndotur do të shkarkohet në një vaske dhe pasi të mbushet, ujrat kalojnë në vaskën tjetër. Ujrat largohen nga vaska pasi të jenë ngurtësuar materialet e ngurta të cilat largohen nga vaskat dhe depozitohen në sheshin e caktuar.

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MMEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

Vaskat rrethohen me lartësi deri 2 m me rrjet metalike të qëndrueshme për të mbrojtur nga rena e njerzeve në të dhe për të menjanuar aksidentet në punë. Ujerat e pastra pas vaskave do të riperdoren ose do të shkarkohen në perroi të Krahës në afërsi të objektit. Thëksojmë që këto ujera nuk përmbajnë elemente kimik ndotes.

3.2.10 Mbetjet sterile.

Më perfundimin e aktivitetit mineral, do të rehabilitohen plotësisht sheshi i depozitimeve të sterileve së bashku me shkallët e karrieres dhe rrugën e lidhjes së këtij objektit me rrugën Kalivaç-Krahës në drejtim të karrieres së subjektit.

Këto sterile nuk shkatohen ndotje të tokës në sheshin ku depozitohen sepse kanë të njëjten përberje mineralogjike. Sterilet e nxjerra nga hapja e karrieres, dhe rrugëve jashtë objektit dhe jashtë karrieres si dhe nga krijimi i sheshit të depozitimit të sterileve, janë inerte që do të përdoren për mirmbajtjen e rrugëve ekzistuese dhe ndërtimit të rrugëve të reja, pjesa tjetër e mbetur do të rikthehet në përmbushjen e hapsirave të shfrytëzimit për të kryer rehabilitimin e tyre. Mbetjet e krijuara nga veprimtaria humane e punonjësve ose nga proceset e punës do të transportohen në sheshin e depozitimit të miratuar nga pushteti vendor.

Në fazë të dytë që është fazë e shfrytëzimit këto sterile do të rikthehen në karriere për të mbushur hapësirat e shfrytëzimit që do të shërbejnë investitorit për shfrytëzimin maksimal të rezervave të mineralit të gelqerorit pllakor. Thëksojmë që këto sterile janë inerte me përberje mineralogjike të njëjta me depozitimet e terrenit ku kryhen punimet, prandaj nuk demtojnë faunën dhe florën e zonës.

Lidhur me ndikimet negative nga përdorimi i burimeve thëksojmë:

Burimet që i vijnë në ndihmë zhvillimit të aktivitetit të shfrytëzimit janë:

1- Energjia elektrike që përdoret:

- Për kompresoret e prodhimit të ajrit të komprimuar, për shpimin e birave në frontet e punës.
- Për sondën e shpimit që do të përdoret për shpimin e birave për futjen e telit të diamantuar.

2- Lenda plasese fitil detonant e cila përdoret për spostimin e pllakave nga masivi dhe do të jetë në sasia shume të vogla.

Në rastin konkret energjia elektrike nuk ka ndikime negative në mjedis sepse është burim i pastër energjie po kështu edhe lenda plasese e përdorimit civil janë prodhime të teknologjive të fundit bashkohore të cilat në procesin kimik digjen plotësisht dhe nuk emetojnë lende helmuese në tokë dhe në ajër.

Në mbyllje të aktivitetit në zbatim të akteve ligjore dhe Urdhërit të Ministrisë Nr.302 datë 12.04.2011 “ Për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare , të menjës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare, si dhe urdhërit Nr. 383 datë 20.05“ Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të veprimtarive për mbylljen e një veprimtarie minerare’ të cilat janë në zbatim të ligjit mineral nr.10304 datë 15.07.2010, është hartuar edhe plani i rehabilitimit të zonës që do të shfrytëzohet.

3.2.11 Infrastruktura ekzistuese.

Rrjeti rrugor mund të themi që është në gjendje disi të mirë. Përmendim rrugën automobilistike Kalivaç-Krahës që kalon në afërsi të vendodhjes ku do të kryhet aktiviteti nga ku do të kryhet lidhja e këtij objekti me këto rrugë nëpërmjet një degezimi që do të ndërtohet i ri.

3.2.12 Projekti i rehabilitimit progresiv dhe perfundimtarë i zonës minerare.

Masat për rehabilitimin e objektit hap pas hapi, konsistojnë në kryerjen e këtyre aktiviteteve :

- a) Pastrimi i shesheve nga mbetjet e shfrytëzimit (makineri e pajisje, mbetje teknologjike).
- b) Krijimi i sipërfaqeve për mbjellje;
- c) Hapja e gropave ku do të mbillen fidanet;
- d) Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidane pemesh të zonës dhe pyllezim me shkurre të egra dhe barishte të ndryshme;
- e) Mirembajtjen e sipërfaqeve të mbjella.

Për të krijuar sipërfaqet për mbjellje shkurre ose barishtesh të zonës, subjekti parashikon në mesin e vitit të gjashtë dhe në fillim të vitit të shtetë. Megjithatë kariera do të ndërtohet në një sipërfaqe e cila nuk është kryesisht e zhveshur, subjekti duke respektuar legjisllacionin në fuqi dhe duke e konsideruar mjedisin çështje shume të rëndësishme ka planifikuar fonde të veçanta financiare për të

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MMEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

rehabilituar sipërfaqet e shfrytëzuara me ane të mbjelljes së fidaneve të pemeve të zonës si pisha, shkurre.

Ne përfundim të shfrytëzimit me punime sipërfaqësore do të kryhet rehabilitimi i shkalleve të karrierës, sheshit në kuotën +260, sheshit të depozitimit të sterileve, rruget për hapjen dhe shfrytëzimin e këtij objekti kur ato ndodhen jashtë karrierës.

Punimet që do të kryen janë:

- ✓ Coptimi i betoneve të shesheve të objekteve të ndërtimit apo të bazamentit të makinerive.
- ✓ Transporti i mbetjeve të ngurta të mbetjeve të krijuara nga thyerja e betoneve të portave në sheshin e depozitimit nga pushteti vendor.
- ✓ Sistemit sipërfaqësorë të prekës nga aktiviteti i minerar, nivelimi, hapja e kanaleve për disiplinimin e ujërave sipërfaqësore nga rreshjet e shiut ose bores.
- ✓ Hapje grupash për mbjelljen e fidanave.
- ✓ Mbushje me dhe humusor të gropave.
- ✓ Furnizim mbjellje me drurë dhe bar të gjelbër që rriten në zonë si breth, pisha, etj
- ✓ Mirmbajtje dhe zëvendësim të fidanave të demtuara deri 4 vjet pas mbylljes e

Aktivitetit.

Një përshkrim i analizimit të alternativave të mundshme për zbatimin, e projektit ose komponenteve të veçanta të tij (si aksesit rrugor, administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lendeve djegëse, vendodhja e projektit etj) si dhe sqarimi i arsyeve kryesore për alternativën e propozuar, duke marrë parasysh ndikimet në mjedis të secilës alternative, si dhe në rast se ka mendimet dhe sugjerimet e institucioneve përgjegjëse që mbulojnë fushën e zbatimit të projektit.

Mundësia e alternativave për organet vendim marrëse për të marra në konsiderat për përzgjedhjen e vendodhjes së projektit nga subjektet minerare në teresi janë në nivelin zero për keto arsye:

- Zona minerare dhe objekti përcaktohet nga MEI me propozim të AKBN dhe shpallet në planin tre vjeçar dhe një vjeçar të Ministrisë.

- Investitorët që kryejnë aktivitetet minerare janë para një fakti të kryer për pjesëmarrje në tender të zonave minerare të shpallura për konkurim.

Subjekti "Alion" Sh.p.k. ka marrë pjesë në konkurimin e zhvilluar në MEI për përfitimin e të drejtës për aplikimin në QKL për Leje Minerare shfrytëzimi për zonën minerare Nr. 347/6 dhe në datën 02/10/2020 me shkresën Nr.7845/2 Prot. është njoftuar nga MIE si fitues i këtij konkurimi dhe ka fituar të drejtën e përgatitjes së dokumentave përkatëse për pajisjen me leje minerare shfrytëzimi në zonën konkurrese Nr. 347/6. Është zgjedhur kjo zonë duke qenë se konsiderohet si një objekt me rezervë të konsiderueshme të mineralit të gelqeror pllakor në trajtë pllake në baze të studimeve të kryera.

Për shfrytëzimin e këtij objekti, pjesë e procedurës është edhe aplikimi pranë Ministrisë së Mjedisit për Procedurën e thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (*aktiviteti përshihet në Shtojcën 1 Kodi 19*). Përse i përket aksesit rrugor Objekti do të lidhet me rrugën automobilistike nacionale Kalivaç-Krahës nëpërmjet degezimit të ri që do të ndërtoje shoqëria "Alion" Sh.p.k. e cila është në aktivitet.

4 PËRSHKRIMI I GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESË TË MJEDISIT QË MUND TË NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR DUKE PËRFSHIRE.

4.1 Përshkrim të karakteristikave fizike të zonës së projektit.

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti ndodhet në Njesinë Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastrë. Shtrihet në pjesën perëndimore të kodrave të Krahësit.

Kjo perben një nga nennjesitë me të mëdha fiziko-gjeografike të maleve përreth. Lartësia e tij në afërsi të zonës minerare 347/6 është 350 m. Kufiri i këtij masivi shënohet nga lugina e lumit të Vjose dhe perroit të Krahësit që ndodhet mbi fshatit të Krahës i cili ndodhet në perëndim të këtij masivi. Ai përbehet kryesisht nga një masiv i madh i të gelqeroreve pllakor për prodhimin e pllakave. Në këto masiv janë në shfrytëzim mbi 3 objekte gelqeroresh pllakor.

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MMEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

4.1.1 Pershkrim i faktoreve klimatike.

Zona minerare Nr.347/6 Krahës perfshihet ne Zonen Qendrore jugore te zones klimatike mesdhetare te Shqiperise. Rajoni rreth saj ndikohet nga klima kontinentale me dimer relativisht te ashper e te ftohte dhe vere te fresket e te ngrohte.

Faktoret e formimit te klimes grupohen ne faktore kozmike, planetare (Tokesore) dhe lokale. Ne grupin e pare hyjne karakteristikat e qendrueshme ose te ndryshueshme te Diellit dhe te hapësirës kozmike, ne grupin e dyte karakteristikat e te gjithë siperfaqes se tokes dhe te atmosferes, kurse ne grupin e trete karakteristikat e ndryeshme ose te ndryshueshme te ajrit dhe te tokes se vendit ne fjale. Ne terresine e faktoreve klimeformues eshte e veshtire te behet nje renditje e sakte, per arsye se secili prej tyre ndikon vazhdimisht ne formimin e klimes, nderkohe qe roli dhe rendesia e tyre eshte e ndryshueshme ne vende te ndryshme. Ne rast se do te benim nje fare renditje, atehere ne radhe te pare duhet te vendosim rrezatimin diellor, sepse sasia dhe intensiteti i tij percaktojne karakteristikat themelore te klimes. Ndikim te madh ne klimen e vendit tone kane detet Adriatik dhe Jon. Deti Adriatik duke qene i rrethuar nga Gadishulli i Ballkanit dhe i Apenineve eshte relativisht i ftohte dhe per kete arsye roli i tij zbutes mbi klimen eshte me pak i ndjeshem se sa i detit Jon. Deti Jon duke qene i hapur nga jugu, rrihet me teper nga ererat e ngrohta te Afrikes, ky det i jep klimes jug-perendimore te Shqiperise nje karakter edhe me te theksuar mesdhetar.

Zona minerare konkurruese Nr.347/6 Krahës perfshihet ne Zonen lindore te zones klimatike mesdhetare te Shqiperise. Rajoni rreth saj ndikohet nga klima kontinentale me dimer relativisht te ashper e te ftohte dhe vere te fresket e te ngrohte.

Dimri qe pergjithesisht eshte i ashper e me lageshti qe shoqerohet shpesh dhe me rreshje te vogla bore, te cilat disa here arrijne trashesi mbi 0.1 deri 0.5 m. Bora fillon të bjere nga fundi i muajit nëntor e vazhdon thuasje deri ne muajin mars. Ndersa vera eshte e ngrohte me lageshti, pasi eshte buze lumit Vjose . Ne zone ka mbi 1650 ore ndriçim dielli, muaji korrik me 2855 ore e muaji dhjetor 75 ore.

Temperaturat në zonë luhaten nga -10 deri në 5 grade në dimër dhe 30-35 gradë celsius në verë pa përjashtuar raste të veçanta të luhatjes së temperaturave. Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte 12.6 grade celsius, ne korrik e gusht temperatura shkon nga 26 - 35 grade celsius, ndersa ne janar zbret ne 6 grade celsius, here here disa grade nen zero.

Vlera mesatare e rreshjeve arrin ne 2215 mm/vit, dhe ne periudhen tetor - maj bien 75% e tyre. Sasia e rregjistruar e rreshjeve maksimale eshte 168 mm shi ne 24 ore (viti 2006).

Lageshtia e ajrit sipas stineve rezulton nga 68 % - 74 %. Drejtimi i erërave eshte kryesisht Veri Perendim – Jug Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshem te lugines dhe ne raste te rralla terthor me te.

Drejtimi i erërave eshte kryesisht Veri Perendim–Juge Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshem te lugines dhe ne raste te rralla oblik me te.

Ushtrimi i aktiviteti te shfrytezimit dhe perpunimit te gelqerorit pllakor, duke marre ne konsiderate masat e parashikuara ne projekt, nuk do te ndikoje ne ndryshimin e parametrave fizike te ajrit dhe nuk do t'a ndote ate. Zona ku do të kryhet shfrytëzimi bën pjesë në zonën me klimë mesdhetare kontinentale e izoluar plotësisht nga rrymat e ngrohta që vijnë nga mesdheu dhe Adriatiku. Zona kryesisht është me verë të nxehtë e të thatë, reflektimi i rrezeve të diellit nga gëlqerorët e bën të nxehtë këtë zonë ndërsa në dimër zona është me rreshje shiu e dëborë dhe nën efektin e acartë të malit të Tomorrit që ndodhet në veri të zonës.

Zona eshte me klime me vere te thate e te nxehte dhe dimer te ftohte dhe te lagesht. Temperatura mesatare vjetore maksimale arrin 30°÷37° C dhe ajo minimale arrin 0÷10° C.

4.1.2 Pershkrim i gjeologjise dhe tokes ne zonen e projektit.

Subjekti “Alion” Sh.p.k. ka fituar te drejten qe te aplikojë ne Qendren Kombetare te Biznesit Tirane per zona minerare konkurruese nr. 347/6 ish leja minerare Nr.1107 per leje minerare shfrytezimi. Kjo zone ndodhet ne teritorin e Njesise Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër.

Teritori ku do te kryhet veprimtaria minerare e shfrytezimit te gelqeroreve pllakor ndodhet ne zonen Jonike e cila eshte shume e pasur me karbonate te moshave te ndryshme si ato te Kretakut te Poshtem (Cr1) dhe Kretaku i Sipërm (Cr2) te cilat ndodhen ne malin e Kudhesit me lartesi 1907 m dhe te malit te Tartarit me lartesi 1971 m. Keto dy male ndodhen ne formacione te Kretakut te Siperem. Me ne perrendim te ketyre maleve kemi kalime graduale ne formacione te Kretakut te

Poshtem (Cr1). Nje pulle e vogel e Kretaku i Sipërm(Cr2) ndodhet midis fshatit Dorez ne jug dhe fshatit Dhemblani ne veri. Kjo pulle e formacioneve te Karbonateve ndodhet buze lumit Vjose. Ne pikepamjen gjeologjike objekti ndodhet ne pjesen e krahines qendrore jugore. Ndertimi gjeologjik eshte i thjeshte i cili eshte pasqyruar edhe ne relivin e krahines qe gjithashtu eshte i thjeshte. Tipari me karakteristike morfografik i relievit te saj eshte nderthurja shume e regullt e vargjeve malore me luginat qe pasqyrojne nderthurjen e strukturave kryesore te krahines te antiklinaleve dhe sinklinaleve. Siperfaqja ne te cilen do te zhvillohet aktiviteti i shfrytezimit eshte formacion shkembor karbonatik i perfaqsuar nga gelqerore pllakor dhe koralore masive.

Zona ne te cilen ndodhet objekti perfaqson nje pjese te shpatit te kodrave te Krahësit i cili perfaqson vazhdimin e malit te Tomorit dhe ben pjese ne zonen Gjeologo-Tektonike – Jonike zona malore jugore e Shqiperise.

Zona e studjuar, ku jane kryer dhe punime kerkim zbulimi dhe shpime te ndryshme ben pjese ne shpatin lindor te kodrave te Krahësit, te cilat ka nje shtrirje te pergjitheshme VP-JL me azimut 320° - 340° . Me nje gjatesi rreth 3-4 km dhe gjerresi qe shkon 2-5 km. Siperfaqja e tij eshte rreth 42.75 km^2 . Gjatesia e kesaj zone eshte rreth 3 km dhe gjerresia 0.5-0.7 km. Pas kryerjes se punimeve te kerkim zbulimit ne kete zone jane marre informacine me te sakta lidhur me:

- Formacionet gelqerore, perberjen kimike dhe vetite fiziko-mekanike te tyre;
- Tektoniken dhe çarshmerine e formacioneve karbonatike dhe bllokshmerine e tyre;
- Elemente te tjere lidhur me punueshmerin e gurit;
- Ujembajtshmerine dhe zhvillimin e fenomenit te karstit;

Ne ndertimin gjologjik te zones se shfrytezimit dhe me gjere marrin pjese shkembinjte sedimentare qe fillojne me pllakat gelqerore te Kretakut te mesem dhe vazhdojne me depozitimet e Paleogenit dhe Neogenit dhe me te reja (Quat) te tipit te aluvioneve dhe deluvioneve.

4.1.3 Pershkrim tokes ne zonen e projektit.

Ne pergjithesi proceset tokformuese (pedogjenike) ne nje pjese te madhe te krahines nuk jane te favorshme. Perhapja e madhe e formacioneve gelqerore, relievi teper i coptuar, shpatet e thepisura, bimesia e varfer e shume e varfer, rreshjet e çrregullta etj nuk jane te volitshem per krijimin e shtreses se dheut ku mbizotrojne terene shkembore dhe toka te varfera skeletore. Ne kete rajon shtrihen toka e hirte kafe. Ato ndodhen ne pjesen e poshtme te maleve. Keto jane nga me pjelloret dhe ne te kultivohen bimet e shumta bujqesore sidomos drithera buke, perime e dru frutor.

Tokat e kafenjta shtrihen kryesisht ne kodrtat dhe ne lartese mezaatare te krahines dhe zene vende te rendesishem ne kultivimin e drureve frutor pjeserisht edhe te dritherave. Veç tokave zonale jane te perhapura edhe toka azonale sic jane tokat aluviale, tokat kenetore etj.

4.2 Pershkrim i biodiversitetit ne zonen e projektit.

Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithe rruzullin tokesor. ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejn bazat per ekzistencen e llojeve. Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet me me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendim marrjesh. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

4.2.1 Pershkrim te habitateve kryesore ne zonen e projektit si dhe harta ilustruese.

Per shkak te mbizoterimit te relievit kryesisht kodrinoro-malor, qe kushtezon ndryshime te dukshme te klimes dhe te faktoreve te tjere, bimesia eshte e shkallezuar ne drejtim vertikale kater breza: brezi i shkurreve dhe i pyjeve mesdhetare; brezi i ahishteve dhe i haloreve dhe brezi i kullotave Alpinei cili shtrihet ne kuota 2000-2200 m. Brezi i shkurreve dhe i pyjeve mesdhetare (deri rreth 800 m – 900 m lartesi) gjendet ne trevat perendimore dhe jug-perendimore. Pjesen e siperme te brezit te shkurreve mesdhetare e zene shkurret qe i rrezojne gjethet gjate stines se dimrit si psh shkoza.

Mbulesa bimore ne zonen ku do te shfrytezohet si dhe ne afersi te saj (pjesa perendimore dhe lindore e malit) nuk eshte e rralle, ku perfaqesohet nga shkurret mesdhetare dhe dushqet, me teper ne formen

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
M MEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

e shkurreve. Ne zone rriten kryesisht shkoza, dellinja , perralli si dhe shume e pasur me lajthi te egra si dhe perfaqesues te familjes graminore.

Ne nje areal mjafte te vogel te ketij bresi rritet edhe ahu i cili nuk e perballon do te thatesiren e zgjatur verore, prandaj ndeshet ne malet e larta ne perendim te ketij objekti..

Ndikimi i njeriut vitet e fundit ka rene , ne kete zone nuk priten dru per perdorim nga banoret.

Shkurret dhe druret jane pjese e rendesishme e mbuleses bimore , jo vetem per evoluimin e peizazhit por edhe per arsyen sepse ato jane percaktuese per mbrojtjen nga erozioni.



Figura 18 Foto te bimesise se zones



Figura 6 Perfaqesues i familjes graminore

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MMEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

4.2.2 Pershkrim te vegjetacionit ne secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre.

4.2.2.1 Shkurret malore.

Shkurret malore.

Ky kat bimor shtrihet nga 380-600 m mbi nivelin e detit e marre ne total kjo bimesi pra ze nje siperfaqe te konsiderueshme te gjithe bimesise zones. Zhvillohet nen nje klime me te bute se brezat e tjere. Ne kete brez shfaqet nentipi I shitblikut perbere nga bime qe i leshojne gjethet.

Duhet theksuar se ky kat eshte mjaft i demtuar nga dora e njeriut dhe e zevendesuar nga toka te punueshme prandaj ne shume sektore te ketij brezi shfaqet degradimi. Ky kat bimor shfrytezohet per kullota dhe dru zjarri. Duhet theksuar se ky kat ka edhe shume bime me vlera mjeksore dhe mjaltese.

Kufiri i siperme vjen e ngrihet ne menyre graduale nga veriu ne jug. Bimet qe rriten kryesisht ne zonen qe do te shfrytezohet jane:

4.6.7.1 Dellinje (juniperus).

Shkurre ose drure monoike ose dioike, gjethet te qendrueshme, halore ose mellugore, te perkunderta ose ne qe thuj nga tre. Lulesas mashkull skajore ose sqetulllore, vezake. Bocezat sqetulllore ose skajore, piqen vitin e pare, te dytin, ose te tretin, rruzulllore ose vezengjashme, mellugat mishtake, te ngjitura ndermjet tyre. Rritet ne zone me pak lageshti, frutet e saj perdoren kryesisht ne industrine mjekesore dhe pijeve alkolike.

4.6.7.2 Shkoze (carpinus).

Drure ose shkurre me lekure te lemuar te perhime. Sythat majemprehte me melluga te shumta. Gjethet ne kohen e lulezimit ne zhvillimin e siper. Fryti me peshtjelle te vrigulluar ose te dhembzuar. Gjethet e saj jane ushqim kryesor per blegtorine.

4.6.7.3 Dushku

Kati i Dushkut, ky kat bimor shtrihet nga 600- 1000 m, eshte i perhapur ne te gjithe zonen dhe ze 21 % te bimesise totale te Malesise . Llojet kryesore te bimeve jane: Dushku, panja, lajthia, bunga, etj. Edhe ky kat eshte shume i demtuar pasi bimedia e tij shfrytezohet per ngrohje ne stinen e ftohte.

4.6.7.4 Ahu

Kati i Ahut dhe i haloreve: ky kat shtrihet nga 1000-1700 m mbi nivelin e detit. E gjithe siperfaqja e ktij kati ze 23% te bimesise se zones. Perhapjen me te madhe e ka ne pjesen jug-lindore dhe lindore. Lloji kryesor i bimes mbizotruese eshte Ahu, nga e ka marre emrin kati.

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitoklimatike te Shqiperise. Megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja flojistike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore (Graminaceae). Bimet qe rriten ne zonen ku do te shfrytezohet nuk gezojne status te veçante te ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre. Gjithashtu kjo zone eshte e pasur ne bime mjeksore, aromatike e mjaltëse, qe bejne nje pasuri te madhe per krahinen.

4.2.3 Pershkrimin e Faunes ne secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre.

Fauna e kesaj krahine si dhe e gjithe Shqiperise nuk eshte e pasur ne kafshe te medha gjitare barengrenese dhe mishngrenese . Kjo varferi lidhet me gjuetine sistematike e pa kriter sidomos ne te kaluarin , me shpyllezimet dhe kushtet e papershtateshme ekologjike.

Qeveria Shqiptare ka nxjerre VKM qe ndalohet gjuetia dhe prerja e pyjeve per nje periudhe 10 vjeçare. Ligji per gjuetine eshte miratuar dhe ka disa vjet qe eshte ne fuqi dhe i ka dhene rezultatet e tij. Ligji i pyjeve ka hyre per zbatim ne 01.01.2016.

Duke analizuar komponentet e veçante te natyres shqiptare (ndertimin gjeologjik, relievin, klimen, bimesine etj.) eshte theksuar origjinaliteti dhe shumellojshmeria e tyre. Ketij rregulli te pergjithshem i nenshtrohet edhe bota e kafsheve te egra, e cila eshte e shumellojshme dhe ne disa raste origjinale dhe endemike. Nder elementet e mjedisit natyror rendesi te veçante per rritjen e perhapjen gjeografike te kafsheve te egra kane klima, bimesia, pasurite ujore, relieve etj.

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MMEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

Ne teresine e tyre pasurite e medha ujqore te Shqiperise, krijojne kushte te volitshme jetesore per kafshet ne çdo zone gjeografike, ne çdo lartesi dhe ne çdo stine te vitit.

Ne kete grup te madhe te faunes hyjne kafshet gjitare te tokes (mishngrenese dhe barngrenese) , shpezet, zvarraniket, amfibet , insektet etj.

Te gjitha kafshet tokesore te vendit tone jane pothuajse te njejta ose te ngjashme me ato te krejt mesdheut, por sidomos me ato te Mesdheut European. Ky unitet faunistik lidhet me faktin qe gjithë Mesdheu formon nje njesi me vete faunistike ne kuadrin e zones Paleoarkitike, e cila nga ana e vet ben pjese ne nje njesi me te madhe faunistike, ne treven Holarkitike.

Ne pergjithesi fauna e Mesdheut nuk dallon per forma te shumta endemike, por ajo permendet per numrin e madh te perfaqesuesve te disa llojeve te kiroptereve, butakeve, zvarranikeve, te disa insekteve etj.

Fauna tokesore e vendit tone eshte e larmishme, me gjithë demtimet ka filluar te pasurohet pasi u demtua shume. Ajo ka perfaqesuesit e vet ne te gjitha krahinat e zonat gjeografike te vendit dhe ne te gjitha lartesite, ku formohen biocenoza te caktuara.

Ne zonen e projektit dhe perreth saj nga gjitaret rriten lepuri, dhelpra, ujku, ketri, baldosa, derri eger dhe ne zonat e larta takohet edhe ariu, kaprolli etj.

Brezi i shkurreve mesdhetare shërben si një stacion pushimi për dhjetëra shpendë migratore si pupza (Lat. *Upupa epops*), qafë dredhësi (Lat. *Jynx torquilla*), mëllënja (Lat. *turdus merula*). Ndër shpendët më tipik të vegjetacionit janë çafkat, çafka subalpine, çafka e ullirit, harabela, grifsha, gushkuqi, skifterat, sorra, shapka, trumcaket etj. Gjithashtu ky brez shërben si shtëpi për shumë gjitarë si nuselala, qelbësi, dhelpra, iriqi dhe baldosa, si dhe të llojeve të ndryshme të minjve dhe brejtësve të tjerë. Zonat hulumtohet nga lakuriqët e natës (Lat. *Vespertilio murinus*) për ushqim. Ne zone rriten edhe perfaqesues te zvarranikeve si dhe nje shumellojshmeri insektesh.

Vleresimi mbeshtetet kryesisht ne studimet e kryera nga te huajt dhe Shkencetaret Shqiptare me karakter taksonomik ne fushen e entomologjise, te cilat trajtojne perberjen llojore te insekteve te rendeve: Coleoptera, Lepidoptera, Hymenoptera, Hemiptera, etj., si dhe studime te veçanta me karakter biologjik per isekte demtuese, si tenja e rrushit (polyc botrana Schiff), krimbi misrit (*Pyrausta nubilalis*), miza e ullirit (*Dacus olean*). Studime jane kryer gjithashtu edhe per grupe te tjera shtazore: butaket, ekinodermat, reptilet, gjitaret, etj. Insektet këtu janë përfaqësuar nga një numër i madh të familjes së brumbujve (brumbujt), grerëzave, bletëve dhe milingonave, si dhe familjet e fluturave, pilivesave, mushkonja etj. Fauna qe rritet ne zone nuk gezon status te veçante te ruajtjes kombetare dhe nderkombetare.

Amfibët

Ne kete zone numerohen disa lloje amfibesh si ne tabelen bashkangjitur. Disa nga llojet e pranishme shfaqin valence te larte ekologjike dhe jane te lidhura ngushtesisht me habitatet ujqore. Ketu futen *Salamandra*, *Triturus vulgaris*, *Bombina variegata*, *Rana graeca* etj) , gjithashtu ka edhe lloje qe jane te lidhura ngushtesisht me habitatet pyjore, por qe kane perhapje te kufizuar (*Rana temporaria*, *Triturus alpestris* etj.).

Reptilet.

Ne zonen e studjuar dhe me gjere numerohen disa lloje reptilesh si me poshte. Ne kete grup shtazor gjejme: lloje te lidhura ngushtesisht me habitatet pyjore dhe me valence te larte ekologjike si Gjarpri i ujit *Natrix natrix*, Neperka *Vipera ammodytes* etj, lloje qe jane te lidhura ngushtesisht me habitatet pyjore, por qe kane perhapje te kufizuar si Neperka e vogel e malit *Vipera ursinii*, Zhapiu vivipar *Lacerta vivipara* etj. dhe lloje qe jane te lidhura pjeserisht me habitatet pyjore si Zhapiu me tri viza *Lacerta trilineata*, Hardhuca e barit *Podarcis taurica*, Shigjeta e shkurter *Coluber gemonensis*, etj.

Llojet e reptileve te pranishem ne zone bejne pjese ne listen e llojeve me status te pafavorshem.

Shpendët Ornitofauna e rajonit per rreth zones se kerkuar eshte e pasur ne numer llojesh dhe per shumicen e tyre gjendja eshte relativisht e mire.

Statusi i rrezikimit te ornitofaunes Pjeserisht llojet e vrojtuar deri me sot ne kete zone kane status te pafavorshem ruajtjeje. Habitatu ku perqendrohet pjesa me e madhe e tyre eshte ai i

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

pyjeve, Gjithashtu te rendesishem jane edhe zonat shkembore te pashqetesuara, lendinat e pashfrytezuara, shkurret e shendetshme si dhe disa ndertime te vjetra te shoqeruara me çati.

Gjitarët Ne rajon listohen 10 lloje gjitaresh te cilet takohen shpesh dhe 11 gjitare qe jane me pikpyetje si me poshte, perfshi këtu lloje te raportuar dhe te pritshem. Ky numer perben rreth 26% te gjitareve ne territorin e Shqiperise. Ne kete grup vertebroresh perfshihen lloje te lidhura ngushtesisht me pyllin. Pervec tyre ne komunitetin e gjitareve perfshihen dhe lloje te pyllit por qe vizitohen edhe habitate te tjera si Iriqi *Erinaceus concolor*, Urithi i verber *Talpa caeaca*, Miu bisht-gjate *Apodemus sylvaticus* etj. si dhe lloje shoqeruese te pyllit perfshire Lepurin e murrme *Lepus europaeus*, Nuselalen *Mustela nivalis* etj.

Statusi i rrezikimit për gjitarët

Ne kete zone 18 lloje apo 60% e gjitareve te pranishem ne zone kane status te pafavorshem ruajtje ne shkalle kombetare.

Statusi i rrezikimit për gjitarët

Ne kete zone 18 lloje apo 60% e gjitareve te pranishem ne zone kane status te pafavorshem ruajtje ne shkalle kombetare.

*4.2.4 Pershkrimin e zonave te Mbrojtura prane vendit ku propozohet te zbatohet projekti ,
perfshire edhe monumentet natyrore te mbrojtura me ligj.*

Siç edhe eshte theksuar aktiviteti i shfrytezimit te mineralit te gelqeror pllakor ne objektin “Krahës”, Njesia Administrative Krahës , Bashkia Memaliaj , Qarku Gjirokastër. Ne afersi te ketij objekti nuk ka zona te mbrojtur,Pejsazhe te mbrojtur,monomente natyre,ose ndonje veper qe eshte ndertuar nga dora e njeriut. Pershkrim i cilesise se mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese

4.2.5 Cilesia e ujerave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te Thelluar te VNM-se.

Me zhvillimin dhe rritjen e popullsisë, rritet edhe kërkesa për ujë të një cilësie të mirë, për higjienën vetijake, turizëm, vaditje në bujqësi, përdorim në blegtori, energjetikë, për ftohje në termoenergjetikë dhe industri, si dhe për peshkim, akuakulturë, lundrim etj. Këto aktivitete, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikojnë në cilësinë e ujërave. Burimet kryesore të ndotjes së ujërave në Shqipëri në dhjetëvjeçarin e fundit janë shkarkimet urbane. Ujërat e zeza urbane dhe shkarkimet e tjera industriale derdhen drejtpërdrejt në kanalet ujëmbledhëse dhe shkojnë në lumenj, liqene ose bregdet.

Ne afersi te zones qe do te shfrytezohe kalon perroi i Krahësit i cili ndodhdet ne lindje te karrieres, poshte saj. Duke qen se zona nuk ka nje popullim te madh , ujerat e zeza te fshatrave perreth jane sistemuar me gropa septike cilesisa e ujit te ketij lumi eshte ne parametra normale dhe jo i ndotur.

4.2.6 Cilesia e ajrit ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se.

Persa i perket cilesise se ajrit ne zone ai konsiderohet me parametra te pranueshem duke qen se ndodhet larg zonave te banuara dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe zhvillimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk do te shkaktoj ndotje te ajrit sepse nuk do te kete emetime te gazeve ndotes.

4.2.7 Niveli i zhurmave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se.

Ne afersi te projektit nuk ka veprimtari te cilat te shkaktojne zhurma mbi nivele te lejuara dhe te shkaktojne ndotje akustike.

4.2.8 Administrimi i mbetjeve ne zonen ku propozohet projekti.

Zona ku do zhvillohet aktiviteti eshte ne largesi rreth 2.0 km ne vije ajrore nga zona me e afert e banuar qe eshte fshati “Krahës”. Mbetjet urbane qe do te krijohen nga aktiviteti i perditshem i punonjesve do te depozitohen ne kontenier plastik te veçante dhe me pas do te evadohen drejt venddepozitimeve te caktuara. Zonat e banuara ne afersi kane venddepozitimet e tyre per mbetjet urbane.

4.2.9 Probleme te tjera nese evidentohen te tilla si erozioni i tokes, zjarret, ndotje historike etj.

Dihet se intensiteti i erozionit varet nga faktoret fiziko-geografike si perberja litologjike, relievi (kryesht pjerresia e tij), kushtet klimatike , shkalla e mbuleses me bimesi dhe tipi i saj dhe nga veprimtaria prodhuese e njeriut. Terreni kodrinor-malor i zonës favorizon fenomenin e erozionit është e domosdoshme të punohet për mbrojtjen e tokës nga ky fenomen, duke ndërtuar prita malore apo sistemimin e tokës, si dhe kanalizimin për kullimin e ujërave atje ku ndihet e domosdoshme.

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE ZONA MINERARE NR.347/6, OBJEKTI “KRAHËS”, BASHKIA
MEMALIAJ QARKU GJIROKASTËR.**

Zjarret kane qen shqetesuese per komunitetin, ne disa raste edhe te qellimshme nga njerez te pandergjegjshem per te rritur siperfaqe te kullotave apo edhe faktore te tjere jane krijuar vatra zjarri. Ne kete drejtim kane qene te shpejta nderhyrjet nga organet e pushtetit vendor dhe komunitetit dhe kohet e fundit edhe si faktore i ndergjegjesimit te komunitetit nuk ka patur raste te djegies se pacelave dhe demtimit te pyjeve perreth zones ku do zbatohet projekti.

4.2.10 Presionet kryesore te mjedisit ne zonen e projektit (te tilla si ndotjet e mjedisit, prerje pyjesh etj).

Ndikimi i njeriut ne mjedis vitet e fundit ka rene , ne kete zone nuk priten dru per perdorim nga banoret. Shkurret dhe druret jane pjese e rendesishme e mbuleses bimore , jo vetem per evoluimin e peizazhit por edhe per arsyen sepse ato jane percaktuese per mbrojtjen nga erozioni.

4.3 Pershkrim i karakteristikave sociale te zones ku propozohet projekti.

4.3.1 Njesia e qeverisjes vendore qe administron zonen ku zbatohet projekti.

Aktiviteti do te zhvillohet ne afersi te fshatit “**Krahës**”, Njesia Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj, Qarku Gjirokastër.

4.3.2 Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike te zones.

Zona perreth (objektit) eshte pak e banuar. Lagja me e afert eshte Fshati i “Krahës” qe ndodhet 2.0 km ne lindje te objektit. Ne afersi te zones dhe rrotull saj nuk ndodhet asnje objekt qe te perbeje rrezik gjate punimeve te shfrytezimit. Popullsia per rreth, fshatit Krahës nuk i kalon 300 banore.

Ne rrethin e Tepelenës historikisht dhe tradicionalisht, e cila vazhdon edhe sot, ka gjetur zhvillim blegtoria dhe me pak bujqesia. Ne periudhen 1955-2000 nje pjese e mire e burrave te kesaj zone punuan qytetin e Memaliajs dhe ne guroret e ketij rrethi dhe ne sektorin e bujqesise. Burimi kryesor ekonomik i kesaj zone ne ditet e sotme ngelet emigrimi dhe me pak blegtoria. Bujqesia ze vend shume te ulet per mungese se tokes se bukes si dhe relievi teper malor qe nuk e favorizon. Duhet theksuar se pjesa e afte per pune ne moshe te re jane larguar prej shume vitesh ne emigracion jashte shtetit. Duke qene se banoret e kesaj zone çdo dite jane duke u larguar dhe braktisur ate per mungese te punes, hapja e nje aktiviteti te tille do te bente te mundur te hapeshin vende te reja pune dhe do te zbuste sado pak largimin e popullsisë. Nje numer i konsiderueshem banoresh punojne ne objektet e tjera te karakterit minerar dhe te ndertimit. Tani ne kete zone jane hapur disa objekte per prodhimin e pllakave te gelqerorit pllakor. Popullsia, relativisht eshte ne gjendje ekonomike nen mesatare.

4.3.3 Perdorimi i tokes ne zonen e projektit.

Zhvillimi i projektit te shfrytezimit te mineralit te gelqeror pllakor me punime te kombinuara do te realizohet vetem brenda siperfaqes 0,24 km², per te cilen subjekti eshte shpallur fitues. Sheshet e depozitimit te sterileve , vendosjes se konteniereve sanduic qe do sherbejn si zyra dhe ambjent sherbimi do te vendosen brenda kesaj siperfaqeje dhe aktiviteti nuk do te kerkoj toke tjeter shtese per funksionimin e tij.

4.3.4 Vlera dhe objektet monumentale dhe arkeologjike ne afersi te zones se projektit.

Lidhja e objektit me rruge ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk prek zonat turistike dhe zonen e mbrojtur.

4.3.5 Administrimi i mbetjeve dhe ujerave te ndotura urbane.

Administrimi i mbetjeve urbane në vendin tonë është i decentralizuar. Në pjesën më të madhe të qyteteve shërbimet e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve kryhet nga kompani privatë të menaxhimit të mbetjeve, të cilat janë të kontraktuara nga bashkitë. Në shumicën e bashkive të vendit, tarifa për menaxhimin e mbetjeve përfshin grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve deri në venddepozitim. Zonat rurale ne vendin tone nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa me e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga Ujërat dhe në këtë mënyre zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore. Zonat e banuara ne afersi kane venddepozitimet e tyre per mbetjet urbane. Persa i perket ujerave te zeza ne fshatra ato jane te sistemuara ne grupa septike.

5 PERSHKRIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PERFSHIHEN.

5.1 Ndikimet negative ne mjedis

5.1.1 Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit.

Gjate dhe pas perfundimit te shfrytezimit, do te kete ndryshime te vogla ne topografine lokale. Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtim i tille i shfrytezimit per punimet siperfaqesore ,qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin. Per shmangien dhe parandalimin e erozionit si dhe per ruajtjen e regjimit te rrymes se ujit te parametrave hidrodinamike te saj, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne teresi dhe i meandrave te shfrytezimit.

Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit, eshte parashikuar mbushja, sistemimi, perpunimi dhe mbulimi i nje siperfaqeje te konsiderueshme. Kjo siperfaqe e perftuar nga trajtimet e mesiperme, do te jape mundesi per rikultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme, duke krijuar njeheresh kushte per parandalimin e eriozionit dhepermisimin e pamjes se pergjithshme te zones se shfrytezuat.

5.1.2 Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitetin e zones se projektit.

